

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5939  
E hënë, 25 nëntor 2019  
çmimi 0.40 €

LV-ja dhe LDK-ja ende  
pa qëndrim të qartë  
për Termocentralin  
'Kosova e Re' **F. 9**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DONIKA KADAJ-BUJUPI **F. 4-5**

## LDK-ja IU AFRUA LV-së PËR INATI TË PDK-së



Sekretarja organizative e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kadaj-Bujupi, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit shpërfaqen nevojën për një reformë të thellë zgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se Kosova duhet t'i themelojë sa më parë institucionet e veta. Kadaj-Bujupi ka thënë se,

ndonëse jo me rezultate të synuara zgjedhore, AAK-ja ka shënuar rritje të mbështetjes popullore në zgjedhjet e 6 tetorit dhe ka mundur përfaqësimin dinjitoz parlamentar. Ajo ka thënë se opozitarizmi i AAK-së do të jetë në shërbim të interesit të përgjithshëm. Kadaj-Bujupi ka thënë se tani presin të shohin se çfarë politika

do të zhvillojë Qeveria e re e Kosovës në raport me dialogun me Serbinë, me projektet për "Zajednicë" dhe korigjimin e kufijve. Duke komentuar bashkëpunimin LV-LDK, ajo ka thënë se afrinë e sotme me LV-në, LDK-ja e ka më shumë për inati të PDK-së që ia ndërpreu bashkëqeverisjen në vitin 2017

Me emblema  
e flamuj të ri,  
FSK-ja sivjet  
shënon Ditën e  
Forcës me mandat  
të ri ushtarak **F. 9**



## Përfundon rinumërimi i votave, Nisma-AKR-PD pjesë e Kuvendit **F. 3**

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka përfunduar të dielën procesi i rinumërimit të 1 407 kutive të votimit nga zgjedhjet e 6 tetorit. Pas 12 ditësh sa ka zgjatur ky proces i urdhëruar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka dhënë lajmin e shumëpritur, duke thënë se tani është hapur rruga për certifikimin e rezultatit zgjedhor. Përfundimi



i këtij procesi ka konfirmuar se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e legjislaturës së VII të Kuvendit të Kosovës

### OPINION

**KOSOVA SI  
ZVICRA? F. 10**

Shkruan:  
Agron HOTI



### AKTUALE

**INICIATIVA QYTETARE E  
SHTIMES I BASHKOHET  
LËVIZJES VETËVENDOSJE F. 7**

**LIGJËRATAT E BIK-UT NË  
BURGJE NUK MJAFTOJNË PËR  
DERADIKALIZIM F. 10**



### EKONOMI

**ME PËRFITIMET NGA EKONOMIA  
DIGJITALE ODA AMERIKANE  
PËRMBYLL AKTIVITETET E JAVËS  
GLOBALE TË NDËRMARRËSISË F. 8**

### KULTURË

**'KOHA ËSHTË E MASKARENJVE,  
PO ATDHEU I SHQIPTARËVE!' F. 20**

Agim  
VINCA



### SPORT

**FERIZAJ E FITON DERBIN  
E MBIJETESËS, DRITA  
NË VEND TË DYTË F. 20**

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kasami: Do të bashkëpunojmë me të gjithë për ta çuar BDI-në në opozitë

SHKUP, 24 NËNTOR - Kryetari i Lëvizjes Besa, Bilall Kasami, në intervistë për "Alsat" ka thënë se në asnjë çast partia e tij nuk do të bëjë koalicion me BDI-në. Sipas tij, tani është koha që kjo parti të kalojë në opozitë, të reformohet me struktura të reja dhe të kthehet në skenën politike. "Së paku katër vjet BDI-ja duhet të jetë në opozitë. Ne si Lëvizje Besa duam ta mobilizojmë të gjithë spektrin opozitar, jo vetëm

atë partiak, që te shqiptarët e Maqedonisë të ketë ndryshime për të mirë", ka deklaruar Kasami.

Në pyetjen nëse do të bashkëpunonte me Alternativën dhe a ka diçka të re për koalicionin, Kasami ka pohuar se spektri opozitar është me dy parti, Lëvizja Besa dhe Aleanca për Shqiptarët. "Spektri opozitar janë dy parti, Lëvizja Besa dhe ASH. Ne e thamë qëndrimin tonë dhe jemi

të sigurt se këto dy parti opozitar kanë kapacitet dhe potencial të jenë fitues në zgjedhjet e ardhshme. Ka edhe forca tjera opozitare, intelektualë, diaspora, profesorë dhe ekspertë tjera të cilët janë të mirëseardhur t'i bashkohen opozitës. Deri sa të vijë momenti, ne si faktor opozitar jemi të gatshëm të shtrijmë dorën e bashkëpunimit me secilin, vetëm që BDI-ja të kalojë në opozitë", ka thënë Kasami.



## Ndryshimi i Kushtetutës sjell përplasje të re Meta - Rama

Derisa presidenti Ilir Meta do të dalë sot (e hënë) para popullit për ta shpallur idenë e tij për organizimin e referendumit në mbrojtje të Kushtetutës, kryeministri Edi Rama ka njoftuar për ndryshime kushtetuese dhe ligjore kundër akteve bllokuese të Ilir Metës

TIRANË, 24 NËNTOR - Fundjava u shpall "armëpushim" politik me mazhorancën e Edi Ramës nga presidenti Ilir Meta. Përplasja e madhe mes dy ish-aleatëve nis sot (e hënë), ditë kur Ilir Meta do të dalë para popullit për ta shpallur idenë për organizimin e referendumit në mbrojtje të Kushtetutës. Në mbrojtje të ligjit themelart të shtetit u rreshtua edhe Edi Rama kur lajmëroi ndryshime kushtetuese dhe ligjore kundër akteve bllokuese të Ilir Metës.

Partia Demokratike i doli menjëherë në mbështetje presidentit, me Edi Palokën, i cili tha se i vetmi ndryshim që duan shqiptarët është largimi i Edi Ramës. Lëvizjen e mazhorancës vetë Ilir Meta e lexoi si tentativë për t'i rrëmbyer kompetencat, ndaj bëri me dije se ditën kur të ndodhë do të jetë në Parlament bashkë me popullin. "Si mund të mos marrë pjesë në inaugurimin e Lana Kushtetutës nga gjysmëparlamenti i oli-

garkëve, bandave dhe ambasadorëve të gishtit?! Sigurisht që atë ditë presidenti do të jetë vetë atje, i pari, me të gjithë popullin shqiptar!", ka thënë Meta.

Përkundrajt kërcënimeve të Ilir Metës, mazhoranca ka nisur punën për ndryshimet e mundshme kushtetuese, por deri atë ditë një tjetër nismë është gati. Në pritje të ditës së madhe Ilir Meta nuk i shpëtoi tundimit për t'u dërguar mesazhe të koduara Edi Ramës, se për atdheun do ta ndjekë shembullin e Mujo Ulqinakut, model i ushtarakut, sipas presidentit i cili i qëndroi besnik betimit të bërë mbi flamur, deri në momentin e fundit kur dha jetën në luftën kundër pushtuesve fashistë.

Në bashkëbisedimin me gazetarët të dielën pasdite, kreu i PD-së, Lulzim Basha, u pyet edhe për idenë e referendumit që e ka propozuar presidenti Ilir Meta



ditë e fundit.

Basha theksoi se e mbështet këtë ide, ndërsa thotë se është një nga pikat e paketës së opozitës. "Mbështesim idenë e referendumit. Është një nga 5 pikat e platformës sonë. Demokracia direkte për të cilën unë jam angazhuar", tha ai. Më tej, kreu demokrat tha se Rama do të marrë një përgjigje mbarëpopullore për nismat anti-demokratike, siç i quajti ai, që kapin Gjykatën Kushtetuese dhe marrin kompetencat e presidentit. "Tentativat për ta kapur Gjykatën Kushtetuese apo përmendja e nismave skandaloze për

ndryshime kushtetuese për t'i dhënë një partie, që po rri paligjshmërisht në pushtet me ndihmën e bandave kriminale, kompetencën e institucioneve të tjera kushtetuese, vërtetojnë faktin se për pushtet Edi Rama është gati të bëjë gjithçka, siç ka bërë gjithçka. Por harron se do të ketë përballë një popull të tërë, do të ketë përballë një bashkim të vendosur dhe më të madhin në historinë e shqiptarëve, më të madhin në numër se asnjëherë më parë kundër tij dhe kundër planit ogurzi për t'i zhbërë themelet e bashkëjetesës

kushtetuese demokratike. Ne do të bëjmë gjithçka për ta mbrojtur Kushtetutën, për ta mbrojtur demokracinë e vendit. Në fillim të dhjetorit do t'i kemi gati propozimet ligjore për reformën zgjedhore, të cilat do të shpallen edhe publikisht. Ne nuk do ta pranojmë zvarritjen e reformës zgjedhore si një alibi të Edi Ramës, por do ta miratojmë sa më shpejt, mundësisht brenda këtij viti, për t'u hapur rrugë menjëherë zgjedhjeve të lira e të ndershme, që janë artikuluar si kusht për negociatat dhe si rruga e daljes së vendit nga kriza", tha Basha.

## Zaev: Nuk arritëm t'i përmbushim pritjet e qytetarëve

SHKUP, 24 NËNTOR - Kryeministri Zoran Zaev pranon se gjatë qeverisjes së tij janë bërë lëshime në disa sfera, përfshi dhe gjyqësorin. Në intervistën për Radio "Evropa e Lirë", Zaevi thotë se qytetarët nuk i përjetuan pritjet e tyre, por shton se në periudhën që pason mund të priten vendime konkrete gjyqësore. I pari i Qeverisë është optimist se BE-ja do ta përmirësojë, siç e quan ai, gabimin historik për mos hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe

Shqipërinë. "Jam i vetëdijshëm për lëshimet e kësaj qeverie, por edhe të sistemit. Zhgënjimi është i pranishëm te qytetarët, por edhe tek unë pasi BE-ja nuk sollti vendim të drejtë. Shpresa jonë mbetet se këtë gabim historik do ta përmirësojnë. Përfundimisht qytetarët nuk i përjetuan pritjet nga gjyqësori dhe për këtë arsye ne zëshëm flasim për atë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen me pushtetin gjyqësor. Ne i sollëm ligjet, Kuvendi i miratoi dhe tani


presim që gjërat të ndryshojnë", tha Zoran Zaev.

Duke folur për rastin "Reket" dhe akuzat e opozitës se Zaevi mund të jetë koka e oktapodit, i pari ekzekutiv thotë se gjithçka që ka le të publikohet duke garantuar se ai nuk nën hetim por është denoncues i aferës korruptive. "Zoran Zaevi është denoncues i rastit. Zoran Zaev nuk është nën hetim. Çka do që ka të lidhur me këtë rast, do të doja ta shihja të zbardhur dhe transparente", u shpreh Zaevi.



Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) i hapet rruga për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit

# Përfundon rinumërimi i votave, Nisma-AKR-PD pjesë e Kuvendit



## Nisma-AKR-PD i gëzohen përfundimit të rinumërimin të votave

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ka përfunduar të dielën procesi i rinumërimin të 1 407 kutive të votimit nga zgjedhjet e 6 tetorit. Pas 12 ditësh sa ka zgjatur ky proces i urdhëruar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka dhënë lajmin e shumëpritur, duke thënë se tani është hapur rruga për certifikimin e rezultatit zgjedhor. Përfundimi i këtij procesi ka konfirmuar se koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë pjesë e legjislaturës së VII të Kuvendit të Kosovës

**EPOKA ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINE, 24 NËNTOR** - Më në fund, të dielën në mesditë, ka përfunduar telenovela e rinumërimin të 1 407 kutive të votimit në Qendrën e Rinumërimin dhe të Rezultateve. Përfundimi i këtij procesi, të cilin e kishte urdhëruar Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), pas ankesave të subjekteve politike, përfundimisht ka nxjerrë koalicionin Nisma-AKR-PD pjesë të Kuvendit me 6 deputetë. Pas përfundimit të rinumërimin, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se brenda 24 orësh mund të parashtrihen ankesa nga subjektet politike në administrim të numërimit që është zhvilluar në QNR. "Besoj se më së largu deri nesër do të mund të bëhen publike, pa dashur të specifikoj ndonjë orë", ka thënë Elezi. Ai ka treguar se para se të bëhet certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve të 6 tetorit, KQZ-ja merr konfirmimin nga ana e PZAP-it dhe Gjykata Supreme se nuk ka ndonjë çështje e cila është në shqyrtim. "Para se Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve ta bëjë certifikimin përfundimtar të zgjedhjeve, merr konfirmimin nga ana e PZAP-it dhe Gjykata Supreme se nuk ka ndonjë çështje e cila është në shqyrtim. Pra, në momentin kur t'i kemi këto konfirmime, si institucion mund ta procedojmë për certifikimin e rezultatit përfundimtar", ka thënë Elezi.

### PZAP-i refuzon ankesën e LV-së për numërimin e 392 pakove të fundit me fletëvotime të diasporës

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) ka refuzuar ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje për t'i numëruar 392 pakot me fletëvotime të ardhura me postë nga diaspora të cilat kishin arritur në KQZ më 12 nëntor. PZAP-i në seancën e mbajtur të dielën ka shqyrtuar gjithsejtë 14 ankesa, prej tyre një ankesë e paraqitur më datën 22.11.2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilin ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që ta bëjë verifikimin

dhe numërimin e 392 pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës dhe 13 ankesa të cilat kanë të bëjnë pretendimet me administrimin dhe rinumërimin e vendvotimeve në QNR. Prej këtyre 13 ankesave, PZAP-i ka bërë me dije se tri ankesa i ka paraqitur LV-ja dhe 10 ankesa i ka paraqitur koalicioni Nisma-AKR-PD. "Ankesa e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje: Anr. 507/2019 e datës 22.11.2019 hedhet e palejueshme, ndërsa ankesat lidhur me administrimin dhe rinumërimin e Vendvotimeve në Qendrën Numërimit dhe Rezultateve (QNR) janë vendosur si në vijim: 5 ankesa janë pranuar të bazuara, 1 ankesë është pranuar pjesërisht e bazuar, 6 ankesa janë refuzuar të pabazuara dhe 1 ankesë është hedhur e pasafatshme", është thënë në njoftimin për media të PZAP-it. Gjithashtu, PZAP-i ka njoftuar se nuk ka ankesa të pavendosura, që do të thotë se ky institucion i ka shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor të gjitha ankesat e pranuar deri kur është lëshuar kjo komunikatë.

Liderët politikë të koalicionit Nisma-AKR-PD kanë mirëpritur përfundimin e procesit të rinumërimin të mbi 1 400 kutive të votimit, proces ky që ka siguruar që ky koalicion ta kalojë pragun zgjedhor dhe të bëhet pjesë e legjislaturës së VII. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, përmes një postimi të publikuar në faqen e partisë në "Facebook", ka vlerësuar se koalicioni Nisma-AKR-PD përfundimisht është pjesë e Kuvendit të Kosovës. Ai ka bërë me dije se vetëm tani mund të flasim për një rezultat të rregullt zgjedhor. "Pas përfundimit të rinumërimin të mbi 1 400 vendvotimeve dhe numërimit të të gjitha votave të rregullta, vullneti i qytetarëve të Kosovës u lexua. Nisma dhe koalicioni ynë do të jenë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Tanimë mund të flasim për një rezultat të rregullt zyrtar. Me këtë rast, falënderoj anëtarët, simpatizantët dhe votuesit e koalicionit tonë për mbështetje në këtë garë zgjedhore. Ashtu siç kemi thënë që në fillim, Nisma dhe koalicioni ynë do të jenë

pjesë e Kuvendit të Kosovës falë votës dhe mbështetjes se mbi 42 000 votuesve. Urime të gjithë votuesve të koalicionit tonë!", ka shkruar Limaj. Edhe lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka thënë se rinumërimi i votave të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit ka konfirmuar se koalicioni Nisma-AKR-PD është pjesë e Kuvendit të Kosovës. "Përpjekjet për ta manipuluar vullnetin e popullit të Kosovës janë kundërshtuar dhe mbizotëroi sundimi i ligjit. Ne do t'i përfaqësojmë në mënyrën më të mirë interesat e votuesve tanë dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës për prosperitet ekonomik, sundim të ligjit dhe për ruajtjen e miqësisë sonë me Perëndimin dhe Shtetet e Bashkuara në veçanti. Jemi krenarë që vendet tona në Kuvendin e Kosovës kanë shqetësuar Vuçiqin dhe aleatët e tij", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Ky koalicion në Kuvend do t'i ketë gjashtë deputetë: Fatmir Limaj, Behgjet Pacolli, Endrit Shala, Haxhi Shala, Albulena Balaj dhe Mirlinda Sopi.

Flet për "Epokën e re", Donika Kadaj-Bujupi

# LDK-ja IU AFRUA LV-së



Sekretarja organizative e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Donika Kadaj-Bujupi, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit shpërfaqen nevojën për një reformë të thellë zgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se Kosova duhet t'i themelojë sa më parë institucionet e veta. Kadaj-Bujupi ka thënë se, ndonëse jo me rezultate të synuara zgjedhore, AAK-ja ka shënuar rritje të mbështetjes popullore në zgjedhjet e 6 tetorit dhe ka mundësuar përfaqësim dinjitoz parlamentar. Ajo ka thënë se opozitarizmi i AAK-së do të jetë në shërbim të interesit të përgjithshëm. Kadaj-Bujupi ka thënë se tani presin të shohin se çfarë politika do të zhvillojë Qeveria e re e Kosovës në raport me dialogun me Serbinë, me projektet për "Zajednicë" dhe korigjimin e kufijve. Duke e komentuar bashkëpunimin LV-LDK, ajo ka thënë se afrinë e sotme me LV-në, LDK-ja e ka më shumë për inati të PDK-së që ia ndërpreu bashkëqeverisjen në vitin 2017

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 NËNTOR -

**"Epoka e re":** Znj. Kadaj-Bujupi, cili është vlerësimi juaj për zgjedhjet e 6 tetorit, kur tanimë jemi vetëm në pritje të certifikimit të rezultatit të tyre?

**Kadaj-Bujupi:** Së pari Kosova dëshmoi se ka kapacitete institucionale dhe frymë shoqërore për të organizuar zgjedhje të lira dhe demokratike. Së dyti, Kosova po dëshmon se mund ta

bëjë rotacionin e pushtetit në mënyrë demokratike. Nga ana tjetër, duket se edhe ky proces zgjedhor shpërfaqti nevojën për një reformë të thellë zgjedhore, e cila do të mundësonte që vullneti i sovranit të implementohet shpejt dhe saktë, pa deformime nga palët e treta.

**"Epoka e re":** Si AAK keni qenë të bindur se do të dilni të parët në këto zgjedhje. A keni bërë ndonjë analizë si parti për t'i gjetur shkaqet e këtij rezultati jo

## Haradinaj insiston se liberalizimi i vizave mund të ndodhë këtë vit

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ka mbetur më pak se një muaj e gjysmë deri në fund të vitit, por kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, vazhdon të besojë se liberalizimi i vizave do të mund të ndodhë brenda këtij viti. Ai në një intervistë

për "Ksp" ka thënë se edhe pse është ofruar fundi i vitit, dhjetori mbetet opsioni që Kosova ta marrë lajmin për liberalizim të vizave. Në këtë kontekst, Haradinaj ka deklaruar se edhe pse është kryeministër në detyrë do të vazhdojë të

angazhohet që Kosova ta marrë liberalizimin brenda këtij viti. Në këtë intervistë, Haradinaj ka folur edhe për minishengenin ballkanik, ku ka thënë se është kundër kësaj ideje të cilën e quan të rrezikshme për vendin.



# PËR INATI TË PDK-SË



pak deputetë së bashku se në 2017-n. Sigurisht se kjo nuk nënkupton se në garime të ndryshme ose me koalicione të tjera (para)zgjedhore do ta kishim rezultatin e sotëm, por nuk duhet anashkaluar edhe këtë fakt të sipërmendur.

Edhe kjo zhurma që po bëhet lidhur me largimin e PDK-së nga pushteti po shpërfitohet. PDK-në nuk e rrëzoi nga pushteti LV-ja dhe LDK-ja, por Ramush Haradinaj, duke e rrëzuar edhe PDK-në nga pushteti, nëpërmjet dorëheqjes së tij si kryeministër. Së dyti, AAK-ja ia zvogëloi gjasat PDK-së t'i fitojë zgjedhjet duke mos pranuar t'i bashkohet para dhe pas zgjedhjeve të 6 tetorit, e kjo po "harrohet" shpeshherë nga qarqet e caktuara, që po përpiqen me dashakeqësi për t'i homogjenizuar ish-partitë e pushtetit. Nuk ka pasur kundërshtar më të madh politik të presidentit Hashim Thaçi se Ramush Haradinaj, edhe atë nga pozita e kryeministrit. Është hipokrite që kjo të mohohet. Ramush Haradinaj dhe AAK-ja kundërshtuan presidentin Thaçi nga opozita, por sidomos nga pozita e pushtetit. Ramush Haradinaj dhe AAK-ja rrëzuan edhe veten nga pushteti për t'i bllokuar politikën e presidentit Thaçi, të mbështetura heshtazi nga PDK-ja.

LDK-ja, që trumbeton vazhdimisht anti-thaçizëm, për nevoja elektorale e zgjodhi atë president vetëm për të ardhur dhe për të mbetur në pushtet, si dhe vajtonte se PDK-ja dhe presidenti Thaçi ia ndërprejnë bashkëqeverisjen. Afrinë e sotme me LV-në, LDK-ja e ka më shumë për inati të PDK-së që ia ndërpreu bashkëqeverisjen në 2017-n. Sidoqoftë, si AAK duhet edhe të nxjerrim mësim nga procesi i fundit zgjedhor. Fakti se kemi qenë bartës të qeverisë e cila edhe u përball me presione të mëdha nga projekti i rrezikshëm për ndarjen e Kosovës në emër të korigjimit të kufijve na mori shumë energji edhe si parti politike. Tashmë kemi më shumë mundësi, kohë

dhe hapësirë për t'u marrë me partinë. Menjëherë kemi filluar një proces të brendshëm reformues dhe po fokusohemi që ta përtërijmë dhe shtrijmë partinë në aspektin strukturor si dhe ta pasurojmë dhe thellojmë në aspektin ideopolitik.

**"Epoka e re":** Ka mendime të ndryshme nga opinionistë se mund të mos ndodhë formimi i institucioneve e që vendi të shkojë sërish në zgjedhje. A besoni se LV-ja dhe LDK-ja mund të arrijnë një marrëveshje për bashkëqeverisje duke ditur raportet e mëhershme dhe pikëpamjet e elektoratit të tyre, dhe si e shihni ecurinë e këtij koalicioni në rast se arrihet?

Kadaj-Bujupi: Kosova duhet t'i themelojë sa më parë institucionet e veta. Sa i përket mundësisë së një qeverie midis LDK-së dhe LV-së, tërë procesi i bashkëpunimit të tyre para dhe pas zgjedhjeve të 6 tetorit shpërfaqin dallimet e mëdha që mbretërojnë midis tyre jo vetëm për nga aspekti ideologjik. Ende nuk i kemi dëgjuar qartësisht se cili është qëndrimi i tyre i përbashkët për temat që quhen të mëdha dhe që janë jetike për të ardhmen e Kosovës. Por, ajo që është e qartë është se nuk ka subjekte politike që dallojmë më shumë midis tyre në Kosovë se LV-ja dhe LDK-ja si për nga aspekti ideologjik, po ashtu edhe për nga pikëvështrimi i tyre për të kaluarën dhe për të ardhmen.

**"Epoka e re":** Qeveria e re ka shumë tema që e presin. Një prej tyre është dialogu me Serbinë, për të cilën temë edhe ndërkombehtarët po kërkojnë përshpejtim të negociatave. Cili do të jetë roli i AAK-së në këtë temë dhe në temat e tjera që janë në interes të shtetit?

Kadaj-Bujupi: Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka dëshmuar se e mbron në mënyrë të pakompromis interesin e shtetit, e sidomos kur e drejton shtetin, atëherë kur më së shumti ke përgjegjësi për ta mbrojtur. Për këtë, edhe

jo rrallëherë, kemi marrë vendime jopopullore që kanë ndikuar edhe në popullaritetin tonë partiak. Opozitarizmi ynë do të jetë në shërbim të interesit të përgjithshëm. Ta shohim se çfarë politika do të zhvillojë Qeveria e re e Kosovës në raport me dialogun me Serbinë, me projektet për "Zajednicë", korigjimi të kufijve etj. Cili do të jetë fati i tarifës doganore për mallrat e Serbisë? Ç'nënkuptojnë me reciprocitet? Si do t'i qasen çështjes së demarkacionit me Malin e Zi, kur Albin Kurti dhe Shpejtim Bulliqi thonë se nuk është çështje e mbyllur, ndërsa Isa Mustafa se është e mbyllur? Politikën e tyre socio-ekonomike etj?

**"Epoka e re":** Nëse do të merrnit ndonjë ofertë për bashkëqeverisje me LV-në dhe LDK-në, do ta shtronit si diskutim në organet e partisë apo do të vazhdoni si opozitë?

Kadaj-Bujupi: Nuk kemi marrë asnjë ofertë për bashkëqeverisje nga LV-ja ose nga LDK-ja, të cilat ka më se dy vjet që proklamojnë se do ta themelojnë bashkërisht qeverinë e ardhshme të Kosovës.

**"Epoka e re":** Znj. Kadaj-Bujupi, ju edhe në këtë mandat jeni zgjedhur deputete. Çfarë prisni nga kjo legjislaturë dhe a mendoni se do ta përfundojë mandatin deri në fund?

Kadaj-Bujupi: Ky është mandati im i pestë si deputete e Kuvendit të Republikës, për të cilin kam edhe më shumë përgjegjësi, meqë votuesi i AAK-së më besoj përfaqësimin, edhe pse në zgjedhjet paraprake garova në listën e një subjekti tjetër. Do të dëshmoj përsëri se përfaqësimin parlamentar e kuptoj mbi të gjitha si bashkëveprim dhe si bashkëpunim me qytetarë. Shpresoj se kjo legjislaturë do ta përfundojë mandatin e plotë, por kjo do të varet edhe nga përbërja, formati, programi, politikën dhe qëndrueshmëria e ekzekutivit, që përcakton pothuajse çdoherë edhe afatin e mandatit të legjislativit.

të mirë, edhe pse drejtonit qeverinë dhe kishit një koalicion me PSD-në?

**Kadaj-Bujupi:** Ndonëse jo me rezultate të synuara zgjedhore, lista jonë ka shënuar rritje të mbështetjes popullore dhe ka mundësuar përfaqësim dinjitoz parlamentar për t'i shtyrë politikën dhe programin tonë parazgjedhor të paraqitur në këtë proces zgjedhor. Megjithatë, duket se temat dhe agjendat e Qeverisë Haradinaj, si dhe të programit parazgjedhor

të koalicionit AAK-PSD, nuk kanë mundur të adresohen sa duhet. Nga ana tjetër ka prirje për të krijuar një përshtypje të gabuar apo subjektive në opinionin publik. Atë se qytetarët kanë ndëshkuar me votë qeverinë Haradinaj. Përbërja e re e Kuvendit dëshmon se partitë që e kanë përbërë koalicionin qeverisës kanë marrë së bashku më shumë deputetë sesa që kishin para zgjedhjeve të 6 tetorit, ndryshe nga dy ish-partitë opozitare që kanë sot më

## Kurti: Është siguruar shumica parlamentare për qeverinë e re

PRIZREN, 24 NËNTOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se janë siguruar votat për votimin e Qeverisë së Kosovës dhe për të kryeministër. Këtë lajm Kurti e ka bërë të dielën në llogarinë e vet në "Facebook", pas një takimi që ka pasur në Prizren

me kryetarët e tri partive të komuniteteve joshumicë, të cilët do të jenë deputetë të ardhshëm: Rasim Demiri, Fikrim Damka dhe Albert Kinolli. "Në 'Ambient' të Prizrenit, pavarësisht prej rinumërimeve dhe paneleve, u sigurua shumica parlamentare për qeverinë e re. Kryetarët e

tri partive të komuniteteve joshumicë, njëkohësisht edhe deputetë të ardhshëm, zotërinjtë Rasim Demiri, Fikrim Damka dhe Albert Kinolli do ta votojnë qeverinë tonë dhe mua si kryeministër, pa kushtëzime. 6 tetori 2019 është data kur ka nisur ardhmëria", ka shkruar Kurti.



## 'Skifterat' e Gjilanit shënojnë 20-vjetorin e themelimit




**GJILAN, 24 NËNTOR (ER)** - Me një ceremoni të veçantë, grupi i tifozeve i SC Gjilani, "Skifterat", kanë shënuar 20-vjetorin e themelimit. Në këtë aktivitet, në emër të Lutfi Hazirit, ka marrë pjesë nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, drejtuesit e SC Gjilani, legjendat e klubit dhe mysafirë të shumtë. "Uroj që edhe 200 vjet ta trashëgoni këtë kulturë e atmosferë për

klubin, i cili po na bën krenarë të gjithë neve si qytet. Urime 20-vjetori 'Skiftera', president Florim Zuka, legjenda të klubit e kryesi e SC Gjilani. Zoti ju bekoftë!", ka thënë Ismajli. Ndërsa drejtori ekzekutiv i SC Gjilani, Sevdail Robelli, ka thënë se po e festojnë 20-vjetorin e sakrificës pasi "Skifterat" asnjëherë nuk i lanë vetëm. "Në emër të presidentit

dhe kryesisë së klubit, ju premtoj se Gjilani këtë vit do ta festojë titullin e kampionit së bashku me 'Skifterat', të cilët janë akademi e tifozerisë. Këtë kulturë do ta transmetojmë edhe në garat evropiane", ka thënë Robelli. Atmosferën e ka elektrizuar në fund rock grupi Jericho teksa e këndoi këngën kushtuar "Skifterave".

## Komuna e Dragashit bëhet gati për shënimin e 28 Nëntorit

**DRAGASH, 24 NËNTOR (ER)** - Komuna e Dragashit ka njoftuar qytetarët e kësaj komune se në kuadër të Ditës së Flamurit - 28 Nëntorit do të organizojë aktivitete të ndryshme në nderim të kësaj dite. "Të mërkurën, më 27.11.2019, me fillim nga ora 11:00, në oborrin e Muzeut Etnologjik të Komunës së Dragashit do të mbahet programi artistik kulturor kushtuar Ditës së Flamurit. Më pas, duke filluar nga ora 15:30 do të organizohet futboli i vogël me shkollat e futbollit, nga Kosova e Shqipëria, në Qendrën Sportive 'Aroma', në fshatin Buzes", ka njoftuar Komuna e Dragashit.



Sipas këtij njoftimi, më 28 nëntor, me fillim nga ora 10:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Dragashit do të mbahet akademi solemne kushtuar kësaj feste, për të vazhduar më pas me vendosjen e kurorave në shtatoren e Adem Jasharit, Varrezave të Dëshmorëve në Dragash dhe Buqe.

## Zgjerohet rrjeti i ndriçimit publik në lagjet e Prishtinës

**PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER)** - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se krahas përmirësimit të infrastrukturës rrugore është duke investuar edhe në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik nëpër lagjet e kryeqytetit. Një investim i tillë kjo komunë ka njoftuar se është realizuar në lagjen "Bregu i Diellit". "Krahas investimeve në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, po investohet edhe në modernizimin dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik nëpër lagje", ka njoftuar Komuna e Prishtinës. Po ashtu, Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se pjesë e riparimeve dhe intervenimeve në infrastrukturën rrugore në lagje të ndryshme të qytetit është edhe asfaltimi i rrugës "Xhevë Lladrovci".



## Pastrohet liqeni i Batllavës, apelohehet që të mos ndotet uji

**PODUJEVË, 24 NËNTOR (ER)** - Organizata Sundimi i Demokracisë në Kosovë (SDK) ka organizuar aktivitet për pastrimin përreth liqenit duke vendosur edhe tabela që bartin mesazhe për vetëdijesimin qytetar ndaj ruajtjes së ujit të pijshëm në Liqenin e Batllavës, "Uji është jete", "Mos e ndot atë!", "Mendo sot për një të ardhme të shëndetshme" dhe "Vendimi varet nga ti!" Ky është mesazhi që do t'i mirëpresë qytetarët që vizitojnë Liqenin e Batllavës, duke shpresuar që t'i thërrasin ndërgjegjes për ruajtjen e ambientit dhe kujdesin e burimeve ujore. "Megenëse Liqeni 'Batllava' është një prej liqeneve më të mëdha në Kosovë nga i cili furnizohen një numër i madh i banorëve me ujë të pijshëm, janë mjaft të rëndësishme pastërtia dhe ruajtja e mjedisit të pastër", është bërë me dije në njoftimin e SDK-së.

SDK ka vlerësuar se vazhdimisht është aktive, është e përkushtuar që nëpërmjet aktiviteteve të



ndryshme të ndikojë në rritjen e vetëdijes qytetare dhe njëkohësisht të avokojë tek institucionet për përkujdesjen ndaj ujit, duke

siguruar mirëmbajtje permanente përreth liqenit të Batllavës në Orllan.

Ky aktivitet është organizuar në

kuadër të projektit "Aktivizmi qytetar dhe institucional në përmirësimin e gjendjes së mjedisit për ujë cilësor", projekt ky që

mbështetet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është duke u implementuar nga OJQ SDK.

# Me emblema e flamuj të ri, FSK-ja sivjet shënon Ditën e Forcës me mandat të ri ushtarak

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Të mërkurën Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do ta shënojë ditën e saj, me një ceremoni në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Kjo është hera e parë që FSK-ja shënon "Ditën e Forcës" me mision dhe mandat të ri ushtarak, pas fillimit të fazës së tranzicionit që erdhi pas miratimit të ligjeve për FSK-në në Kuvendin e Kosovës. Andaj edhe kjo ceremoni nuk do të jetë krejt e zakonshme. Njësitë e FSK-së do të paraqiten me flamuj dhe emblema të reja, të dekretuara për çdo njësi nga presidenti i Republikës së Kosovës.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se faza e tranzicionit ka sfida, por shprehet i bindur se do ta vazhdojnë realizimin e objektivave bazuar në planin afatgjatë të paraparë për tranzicionin e FSK-së.

Komandanti i FSK-së vlerëson se viti 2019, që është viti i parë i tranzicionit, është vit i suksesit për FSK-në. Madje thotë se janë tejkaluar pritshmëritë. Këtu gjeneral Rama nuk lë pa përmendur partnerët e FSK-së



të cilët po e përkrahin edhe në fazën e tranzicionit. Ai thotë se pa aleatët Forca nuk do të mund të arrinte ku është aktualisht.

Gjatë këtij viti FSK-ja ka nënshkruar kontrata për pajisje, përfshirë automjete taktike dhe sisteme të armatimit.

Në mesin e shumë donacioneve që ka marrë FSK-ja, janë edhe automjetet taktike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vlera e të cilave është rreth 12 milionë. Gjatë vitit të parë të tranzicionit ka pasur përkrahje edhe në shkollimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të Forcës.

Aktualisht janë dhjetëra kadetë të rinj të cilët po i përfundojnë shkollimet në këto akademitë ushtarake më prestigjioze në botë. E vitin e ardhshëm pritet që, për herë të parë, dy oficerë të ri të FSK-së ta përfundojnë akademinë në West Point. Komandanti i FSK-së ka thënë

se vazhdojnë ngritjen profesionale të stafit qoftë me trajnime individuale, akademi ushtarake në botë, por edhe me trajnime e aktivitete të tjera, siç janë garat dhe ushtrimet fushore që FSK-ja sivjet ka marrë pjesë në shumë vende të botës.

## Hoti viziton shkollën shqipe 'Scanderbeg' në Parma

PARMA, 24 NËNTOR (ER) - Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Itali ka vizituar shkollën shqipe "Scanderbeg" në Parma, me kryesues Durim Lika, ku po zhvillohej ora e pikturës me mësues Elona Marika dhe Bernard Basha. Po ashtu, Hoti vizitoi edhe grupin e valleve "Mijëra Yje" nën drejtimin e mësueses Loreta Shahini të Forum Donne Independenti.



Koordinatori Hoti takoi edhe presidenten e Forumit të Grave të Pavarura, Marsida Mehdiu dhe

një pjesë të stafit të këtij forumi, disa mësues të shkollës shqipe, prindër dhe vullnetarë, me të

cilët shkëmbyen përvoja dhe opinione.

Koordinatori Hoti e përgëzoi Likën për përkushtimin e dhënë për shkollën shqipe në Itali dhe e informoi për Programin Nacional për Rininë. "Unë edhe në takimet e mëparshme këtu në Itali jam informuar për punën që bëni ju. Është për t'u vlerësuar lart kontributi juaj për mësimin në gjuhën shqipe sepse vetëm me një përkushtim të tillë shqiptarët kudo në botë do të mund ta ruajnë kulturën dhe gjuhën shqipe.

Unë po jua prezantoj Programin Nacional për Rininë të cilin jemi duke e zbatuar në Kosovë për të gjithë nxënësit pa dallim. Ai është duke u realizuar në formë të garës në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik, Dituri dhe në Sport. Në udhëzuesit që ju kam sjell gjeni të gjitha hollësitë për organizimin e garës. Unë pres bashkëpunim nga ju që nxënësit e diasporës të marrin pjesë edhe në nivelin republikan të garës, që të vijin të garojnë në Kosovë", ka thënë Hoti.

## Iniciativa Qytetare e Shtimes i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije se Iniciativa Qytetare e Shtimes i është bashkuar kësaj lëvizje. Kurti ka treguar të dielën se kjo Iniciativë u formua nga një grup intelektualësh në vitin 2017 që për synimin kishin t'u jepnin fund politikave korruptive të qeverisjes lokale në Shtime dhe një alternativë të re zhvillimore kësaj komune. "Të prirë nga parime të shëndosha

dhe përparimtare, ata gjetën përkrahjen e qytetarëve të Shtimes dhe në vitin 2017 arritën që suksesshëm ta mbështesin kandidaturën e pavarur për kryetar komune të z. Fatmir Rashiti i cili shkoi në balotazh me PANistët. Duke parë që PANistët tashmë ishin shndërruar në një makineri që kokën e kishte nivelin qendror, kjo iniciativë e barti betejën duke mbështetur kandidaturën e z. Fatmir Rashiti për deputet dhe Lëvizjen Vetëvendosje në zgjedhjet e 6 tetorit. Pas fitores së Lëvizjes

Vetëvendosje dhe me PANistët në opozitë, u hapën mundësitë për ndryshime dhe kjo po bëhet e dukshme ende pa u certifikuar rezultatet. Qytetarët, intelektualët, profesionistët, talentet dhe të gjithë ata që në një mënyrë ose tjetër kanë ndihmuar që ky ndryshim të vijë në shprehje e kanë të qartë që duhet shumë punë për ta kthyer vendin në binarët e drejtësisë dhe zhvillimit ekonomik, andaj edhe po shprehën të gatshëm të kontribuojnë që ndryshimi të jetë sa më i plotë. Në këtë frymë na u bashkua



Iniciativa Qytetare e Shtimes sot, që në radhët e veta numëron intelektualë dhe profesionistë të

shquar të asaj komune e të këtij vendi", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Me përfitimet nga ekonomia digjitale Oda Amerikane përmbyll aktivitetet e Javës Globale të Ndërmarrësisë

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER) - Me rrëfime të tjera suksesi janë përmbyllur aktivitetet e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë të organizuar nën udhëheqjen e Qendrës së Inovacionit të Kosovës (ICK). Dita e pestë dhe e gjashtë e Javës Globale të Ndërmarrësisë ka përcjellë para shumë të rinjve kosovarë mesazhin për rëndësinë e ndërmarrësisë dhe sektorit privat në nisjen dhe zhvillimin e karrierës profesionale, por edhe kontributin aq të nevo-

jshëm për shtetin dhe shoqërinë e Kosovës.

Të rinjtë e Komunës së Vitisë patën mundësi të dëgjojnë dhe të marrin përgjigje në pyetjet e tyre për sfidat dhe përfitimet e biznesit nga ndërmarrësi Ardian Hoxha në një aktivitet të organizuar në bashkëpunim me Agjencinë e Zhvillimit Rajonal Lindje, në të cilin mori pjesë edhe kryetari i Vitisë, Sokol Haliti.

Në të njëjtën kohë në Prishtinë, të rinj të tjerë kishin mundësinë të komunikonin me Rron Cenën nga kompania

"FORMON" si dhe Agon Avdimetaj nga kompania "Zombie Soup".

Studentët e Kolegjit AAB dëgjuan përvojat e ndërmarrëseve Shemsije Dërmaku nga "GrandDecor" dhe Pranvera Dalloshi nga "Bliss Cosmetics", në një panel me ligjëruesin Pleurat Mustafa.

Dy gra të tjera të suksesshme, Afërdita Mekuli nga Programi i USAID-it për Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese, si dhe Afrone Rudi nga Deloitte Kosova, ndanë rrëfimet e tjera me një

audiencë të 30 vajzave dhe grave, pjesëmarrëse të programit të Odës Amerikane për Rritjen e Punësimit të Grave, të përkrahur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Dita e fundit u shënua me aktivitetin "Të fillosh biznes digjital në Kosovë", ku të rinjtë u njohën me perspektivën e të bërit biznes në fushën e ekonomisë digjitale me Mentor Latifin nga kompania amerikane Sutherland, si dhe Arianit Fazliun nga kompania "Kutia".

Përmes gjithsej katërbëdhjetë aktivitetesh në Prishtinë, Mitrovicë, Shtime, Drenas dhe Viti, Oda Ekonomike Amerikane synoi frymëzimin e të rinjve kosovarë për përfitimet nga ndërmarrësia dhe sektori privat.

Java Globale e Ndërmarrësisë organizohet në rreth 180 shtete të botës, ndërsa nën udhëheqjen e Qendrës së Inovacionit të Kosovës në Kosovë janë organizuar në tërësi rreth 80 aktivitete në kuadër të kësaj jave nga 48 organizata partnere.



## Kompania SPEEEX do ta vazhdojë aktivitetin edhe në Vushtrri

VUSHTRRI, 24 NËNTOR (ER) - Kompania SPEEEX ka vendosur që ta vazhdojë aktivitetin në Vushtrri. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri. Ai ka thënë se SPEEEX ofron mundësi të shkëlqyera për punë për të rinjtë në fushën e Business Process Outsourcing - BPO. "SPEEEX është nga punëdhënësit më të mëdhenj në Prishtinë, prandaj do të ofrojë mundësi punësimi me paga të

mira edhe për të rinjtë vushtrrias që kanë njohuri qoftë të gjuhës angleze, frënge, italiane apo gjermane. Komuna do të angazhohet për marrëveshje me SPEEEX për ta rritur punësimin në qytetin tonë. Planet e menaxhmentit ishin impesive. Në takimin në zyrën time u urova sukses dhe ofrova bashkëpunim të plotë", ka thënë kryetari Tahiri pas takimit që ka pasur me menaxhmentin e kësaj kompanie.





# LV-ja dhe LDK-ja ende pa qëndrim të qartë për Termocentralin 'Kosova e Re'



Termocentrali "Kosova e Re" llogaritet të jetë investimi më i madh i huaj në Kosovë me vlerë prej 1.3 miliard eurosh. Po ashtu, është llogaritur që gjatë ndërtimit të këtij termocentral do të punësohen 10 000 persona. Ka pasur kritika të vazhdueshme për këtë projekt nga Lëvizja Vetëvendosje dhe shoqëria civile. Gjithashtu, LV-ja kishte publikuar tetë arsye pse duhet të ndalet marrëveshja me "Contour Global". Sot as LV-ja dhe as LDK-ja nuk kanë një qëndrim të qartë për Termocentralin "Kosova e Re". Një burim i gazetës "Epoka e re" brenda LDK-së ka bërë me dije se është diskutuar për këtë projekt, por që palët nuk kanë arritur të merren vesh. Ka mbetur që për këtë temë të diskutojnë liderët e këtyre dy partive

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHINË, 24 NËNTOR - Më 20 dhjetor të vitit 2017 është nënshkruar marrëveshja komerciale për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re" në mes të Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë 'Contour Global'. Termocentrali "Kosova e Re" llogaritet të jetë investimi më i madh i huaj në Kosovë me një vlerë prej 1.3 miliard eurosh, po ashtu është llogaritur se nga ky termocentral do të punësohen 10 000 persona gjatë ndërtimit.

Lidhur me këtë projekt nuk kanë pranuar të flasin as përfaqësues të LDK-së dhe as të LV-së. Gazeta "Epoka e re" ka provuar të marrë prononcime të ekspertëve të ekonomisë nga të dy grupet punuese, të cilët, duke mos dashur t'u përmendet emri, kanë thënë se janë pajtuar që mos të flasin për këtë çështje deri në realizimin e marrëveshjes finale. Por, një burim i gazetës "Epoka e re"

brenda LDK-së ka bërë me dije se është diskutuar për këtë projekt, por që palët nuk kanë arritur të merren vesh. Sipas po këtij burimi, ky projekt është lënë në duart e liderëve politikë të dy partive që të vendosin për këtë çështje. "Është diskutuar nga grupet punuese ky projekt, por nuk ka konkretizime dhe duhet të diskutohet në nivel politik në mes të liderëve të partive", ka thënë për gazetën ky burim.

Për këtë çështje ka folur ministri në detyrë i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluk, në mandatin e të cilit është arritur marrëveshja komerciale për ndërtimin e Termocentralit "Kosova e Re". Lluca ka theksuar se ky projekt është i rëndësishëm jetike për Kosovën dhe ka apeluar te qeveria e ardhshme që të vazhdojë me këtë projekt. Ai ka thënë se është i gatshëm çdoherë të japë çfarëdo informata lidhur me këtë pasi, sipas tij, ka pasur keqkuptime dhe keqinterpretime nga kundërshtuesit e këtij projekti. "Ky pro-

jekt është jetik për Kosovën. Ne kishim probleme serioze të reduktimit me energji pasi blloku 'B1', 'B2' dhe 'A3' kanë rënë nga sistemi në formë të paplanifikuar për shkak të vjetërsisë së aseteve. Si rrjedhojë, bizneset dhe qytetarët janë duke e paguar këtë. Mendoj se është obliguese që qeveria e ardhshme t'i vazhdojë projektet që kanë të bëjnë me energji, pra me format konvencionale, duke i zëvendësuar të vjetruarat me teknologjitë e reja. Investimi i fundit që kemi bërë ka qenë në vitin 1954. Pas kaq vitesh duhet të mendojmë që të kemi energji stabile për qytetarët dhe bizneset. E kuptoj se ka pasur kritika në vazhdimësi nga aktivistët të Vetëvendosjes, por është me rëndësi që këto kritika dhe paqartësi të diskutohen me ne. Jam i gatshëm çdoherë t'u jap informata dhe shumë shpesh ka ndodhur të keqkuptohen lidhur me këtë. Do të ishte me rëndësi që të kuptohet para se të vazhdohet me çfarëdo vendimi. Kam shpre-

hur gatishmërinë të jem i hapur në mënyrë që të gjitha informatat t'ua vë në dispozicion, edhe ato të cilat nuk kanë qenë publike mund t'i hapim dhe t'i diskutojmë", ka thënë Lluca, duke shtuar se Kosova ka nevojë jashtëzakonisht të madhe për energji elektrike. "Në pesë vjetët e fundit kishim rritje të madhe të konsumit të energjisë mbi 20-25 për qind dhe kjo tregon se duhet të përgatitemi për të ardhmen duke mos anashkaluar në asnjë formë mjedisin dhe energjinë e ripërtërishme, që duhet të jetë prioritet numër një. Për energji stabile duhet të kemi format konvencional siç është thëngjilli. Ka raste të tjera kur është dhe gazi, por ne nuk kemi lumenj të mëdhenj dhe asnjë burim tjetër përveç thëngjillit, prandaj palët duhet të kenë kujdes të mendojnë se neve na duhet një energji stabile bazë dhe pjesën tjetër ta zëvendësojmë, pra atë me energji të ripërtërishme. Kosova është vendi i pestë në botë me rezerva të linjtit, që janë mbi 13 miliardë tonë. Konsumi ynë vjetor është 8 deri në 10 milionë tonë. Do të thotë, kemi energji edhe për 150 vjet. Ka rezerva të jashtëzakonshme. Normalisht se thëngjilli nuk është forma më e mirë për ambientin, por tanimë teknologjia ka avancuar dhe sot kemi teknologji që kompakt e marrin dhe CO2 dhe nuk e lënë të dalë në ambient. Në fakt, shumë më shumë do të ketë dem nëse mbesim me Termocentralin 'Kosova A' pasi 'Kosova B' do të futet në filtra. 'Kosova A' është shumë e vjetruar dhe çdo formë e

zëvendësimit do ta shkaktojë ndotjen më të vogël. 'Kosova e Re' nuk duhet të shihet vetëm si një mjet për energji, por duhet të shihet edhe si mbrojtje për ambient dhe si përmirësim i ambientit realisht", u shpreh Lluca. Edhe ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhali, ka apeluar që mos të ndërpritet ky projekt. Sipas tij, duhet të shikohet rëndësia e vendit dhe të lihen anash të gjitha lobingjet kundër këtij projekti. "Duhet të kuptohet se agenda politike dhe kalkulimet politike janë mbi ato ekonomike. Në një situatë të tillë pëson qytetari i Kosovës dhe sektori privat. Unë mund ta kuptoj shoqërinë civile dhe të gjithë të kërkojnë dialogim më të madh dhe llogaridhënie dhe që përmes këtij dialogu t'i qasemi me seriozitet termocentralit qoftë "Kosova A", qoftë "C", derisa Maqedonia me pak thëngjill është duke ndërtuar termoelektrana. Po ashtu, edhe Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina e Serbia. E si mund të ndodhë që në Kosovë të jemi vendi më i pasur me thëngjill dhe të mos kemi kapacitete gjeneruese të mjaftueshme. Andaj, duhet të lihen anash interesat e lobingjeve të caktuara dhe për hir të interesit të vendit mos të mbesim peng i këtij projekti dhe reduktimeve me energji elektrike kur dihet se Kosova ka rezerva të mëdha të thëngjillit me energji elektrike. Kosova ka nevojë për investime të huaja dhe qeveria e ardhshme duhet të jetë fleksibile në këtë drejtim", është shprehur Gërxhali.

# Kosova si Zvicra?



**Shkruan: Agron HOTI**

Ka qenë ëndërr dhe ende s'është molisur bindja se Kosova menjëherë pas çlirimit nga pushtimi serb ka mundur të bëhet si Zvicra. Kjo bindje, se një gjë e tillë ka mundur dhe është dashur të ketë ndodhur, vazhdon edhe sot te një pjesë e shoqërisë sonë, edhe pse me ritëm më të ngadalshëm sepse qytetarët kanë filluar ta kuptojnë që organika e krijimit, ndërtimit dhe konsolidimit të shteteve merr shumë kohë ashtu siç u ka marrë të gjitha shteteve në botë, pa përjashtim. Po të varej zhvillimi dhe konsolidimi i shteteve vetëm nga rrethanat e brendshme dhe po të përqendroheshin shtetet vetëm në punë të brendshme pa i shtrirë këmbët në rrafshin ndërkombëtar, atëherë historia dhe konfiguracioni i globit do të shkruhej dhe dukej krejtësisht ndryshe. Meqë historia e zhvillimit të njeriut, familjes, fiseve, kombit, shteteve dhe rajoneve është e ndërtuar mbi bazën e interesave, atëherë jo rastësisht edhe sot, me gjasë edhe nesër, bota ndahet në atë të zhvilluar, në zhvillim dhe të varfër. Bindja për zhvillim e prosperitet ka qenë shpresa dhe ideali i përpjekjeve të shqiptarëve të hapësirave ish-jugosllave, të cilët shtetin jugosllav nuk e ndienin si të vetin ashtu siç ky shtet përmes metodave represive na shihte si mish të huaj. Dhe është shumë mirë që kishim atë bindje.

Një popull që nuk ka shpresa dhe ëndërra për liri, ai dalëngadalë zvenitet dhe zhduket. Kështu ka ndodhur me shumë popuj e kultura të ndryshme që sot nuk ekzistojnë më. Shqiptarët e hapësirës ish-jugosllave padrejtësisht nuk u lejuan të jetojnë së bashku me trungun e tyre, Shqipërinë. Kjo pati pasojë që, ndoshta, vonë ose kurrë nuk do të mund të riparohen. E një ndër pasojat më të mëdha është se shqiptarët edhe sot përbëjnë pjesën më të varfër në Evropë, pa marrë parasysh orientimin e tyre më pro-perëndimor në Ballkan.

Se shqiptarët shpirtërisht kanë orientim perëndimor këtë e dëshmon edhe orientimi i tyre kryesisht drejt Gjermanisë, Italisë, Zvicrës dhe Austrisë. Edhe konceptin për kombin e bazojmë në të kaluarën etnike dhe kulturore, pra njëjtë siç e

konceptojnë kombin gjermanët, për dallim prej anglezëve dhe francezëve që kombin e identifikojnë me shtetin. Ajo çfarë i mahnit shqiptarët është zhvillimi i jashtëzakonshëm, kryesisht ekonomik, që ka hapësira gjermane, austriake e zvicerane duke mos përjashtuar të arriturat në shkencë, filozofi, industri, kulturë etj. Në zhargonin popullor (kryesisht në Kosovë) Zvicra është marrë si shtet model më i përafërt me hapësirën shqiptare e të cilën ne do të mund ta imitonim. Por, dallimi mes ëndrës, dëshirës dhe realitetit është i madh.

Siç dihet, dokumenti themelues i Konfederatës Helvetike (Shtetit Zviceran) është Karta Federale e vitit 1291 e arritur në mes të komunave rurale të Uri-it, Schwyz dhe Unterwalden. Ashtu sikurse populli shqiptar, edhe Zvicra ka kaluar nëpër pushtime të ndryshme, kryesisht romake, franceze e gjermane, por që këto kanë përfunduar shumë herët. Ashtu sikurse shqiptarët, edhe populli i vyeshëm zviceran, edhe pse i shtrirë në 4 etni, ka arritur ta ruajë identitetin e vet dhe sot ka Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) për kokë banori ndër më të lartën në botë.

Sipas raportit të UNDP-së për Zhvillimin e Indeksit Njerëzor (Human Development Index - HDI) "Zvicra në vitin 2017 kishte HDI 0.944 mbi mesataren e 0.894 të grupit të vendeve me HDI më të lartë si dhe mbi mesataren 0.895 të vendeve të OECD-së (Organisation for Economic Cooperation and Development)". Ndërkohë që, sipas Raportit të UNDP-së të vitit 2016 për shkallën e HDI-së, thuhet se HDI e Kosovës është 0.741, e cila përbën një rëndësi më të ulët në rajon krahas Shqipërisë dhe Bosnje Hercegovinës, të cilat zënë vendin e 85 në botë".

Sipas Raportit të Transparency International mbi Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit në shkallë globale, "Zvicra renditet në grupin tri vendeve të Evropës Perëndimore & Bashkimit Evropian", ndërkohë që "Kosova renditet në vendin 93 në grupin e vendeve të Evropës Lindore & Azisë Qendrore".

Sa i përket nivelit të zhvillimit ekonomik, Shqipëria, Kosova dhe pjesë të tjera të shqiptarëve kanë PBB-në më të ulët në Evropë. Arsytet janë të shumta, disa thonë që nuk kemi qenë sa duhet shtetformues, disa thonë se kemi qenë mjaftueshëm shtetformues, por të tjerët na kanë penguar, disa nuk thonë as ashtu e as kështu, por gjithsesi që kjo skizmë mes

shoqërisë na përcjell me shekuj. Ka edhe të tjerë që thonë se shoqëria shqiptare ka mbetur e pazhvilluar si rezultat i korrupsionit dhe kimit të organizuar etj. Me një fjalë, të gjitha kanë kontribuar nga pak.

Një gjë dihet, se pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane, për dallim prej popujve përbërës të saj (bullgarë, serbë, grekë, rumunë etj.), shqiptarët nuk kishin arritur të ndërtonin sub-sistem, i cili do t'u jepte përgjigje rrethanave të reja. Kurse popujt fqinjë e kishin elementin fetar, i cili i mbante të përbashkuar për rrethana të reja dhe i cili i mban edhe sot. E shqiptarët, trekonfesionalë siç u bënë, nuk e patën këtë mundësi.

Të kaluarën etnike dhe kulturore të shqiptarëve nuk mund ta lidhte mjaftueshëm gjuha shqipe sepse shkollat shqipe në atë kohë mungonin për të ngritur një frymë të fortë identitare, mbi bazën e së cilës shqiptarët do të mund të avancojnë drejt konsolidimit si komb, për t'u futur pastaj nën një ombrellë shtetërore të përbashkët.

Dhe pastaj gjërat rrodhën si rrodhën. Na ndanë, na bënë për pesë pare, na tkurrën territore me qëllim të pamundësimin të produktivitetit ekonomik si bazë për të ardhmen e qëndrueshme të një kombi. Me gjithë vështirësitë e panumërta, si Shqipëria ashtu edhe Kosova, ia dolën të bëhen shtete, por larg standardit të Zvicrës, që është e natyrshme për një shtet që ndërtohet prej zeros, edhe pse ka që nuk pajtohen me këtë rezonim.

E shteti i Kosovës me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare filloi të frymojë, të zhvillohet me të njëjtën ritëm siç zhvillohet çdo shtet i ri. Sigurisht që vështirësitë në këtë rrugëtim janë të shumta, por nga idealizmi i madh që kemi pasur për shtetbërje nuk kemi menduar e, ndoshta, as që kemi dashur të mendojmë për sfida që mund të dalin gjatë rrugës. Gjithmonë kemi menduar për teorinë e zhvillimit dhe ndërtimit të shtetit, por asnjëherë nuk kemi menduar, së paku jo të gjithë, që shteti, si çdo kund në botë, praktikisht drejtohet prej grupeve të interesit dhe se kjo shpesh krijon tension e çoroditje e sidomos gjatë fazave të hershme të shtetndërtimit. Ne nuk mund të përbëjmë përjashtim nga bota sepse ndërtimi dhe zhvillimi i shtetit është një sfidë që do shumë mund dhe kohë, pa marrë parasysh ëndrën dhe dëshirat. Bërja, zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit është sikur fëmija kur rritet, piqet, arsimohet dhe kontribuon për familjen, shoqërinë, kombin dhe shtetin.

Nuk ka sens që punët e një të rrituri t'i bëjë një fëmijë sepse, fundja, anatomia trupore nuk e mundëson një gjë të tillë. Prandaj, është shumë mirë që kemi ëndërruar të bëhemi si Zvicra e jo, p. sh., si ndonjë shtet i dështuar. Sepse një popull që nuk ka ëndërra nuk ka të ardhme.

Në anën tjetër, nuk duhet të harrojmë që fqinjët tanë kanë formuar shtetet e tyre shumë para nesh dhe nuk janë as afër të qenurit si Zvicra. Pse, p. sh., Kosova u dashka dhe paska pasur mundësi të bëhet Zvicër, e nuk paskan pasur mundësi Bullgaria, Greqia, Rumania, Kroacia, Serbia etj.?! Shtetet rajonale janë formuar që mbi 150 vjet dhe ende nuk janë bërë si Zvicra dhe janë shumë larg atij objekti. A nuk paskan dëshirë këto shtete të bëhen si Zvicra?! Pse vetëm Kosova u dashka të bëhet si Zvicra e të tjerët jo?! Edhe pse do të ishte ideale që për 11 vjet shtet të bëheshim si Zvicra dhe të futeshim në librin e Ginisit.

E vërteta është se rrethanat nëpër të cilat ka kaluar Zvicra janë krejtësisht të tjera, krahasuar me ato të Kosovës. Pozicioni gjeografik i Zvicrës është krejtësisht tjetër, krahasuar me atë të Kosovës, kjo sepse Zvicra kufizohet me shtetet më të forta të Evropës, e Kosova kufizohet me ato më të varfërat. Zvicra e ka arritur fazën e industrializimit dhe është duke e zhvilluar edhe më tej atë. Zvicra nuk ka ëndërra të bashkimit kombëtar, ndërkohë që Kosova me hapësirat e tjera shqiptare në rajon, ëndërrojnë bashkimin me Shqipërinë që tregon se shqiptarët ende nuk e kanë përfunduar gjeografikisht komb-konsolidimin e tyre, i cili do të rezultonte me një shtet të vetëm shqiptar.

Kosova dhe fqinjët e saj fazën e industrializimit edhe pse me ekonomi të centralizuar e kanë përjetuar vetëm gjatë periudhës komuniste, ndërkohë që pas rënies së komunizmit rajoni i Evropës Juglindore u de-industrializua pothuajse tërësisht. Kjo nuk duhet nënkuptuar që komunizmi ishte i mirë për shqiptarët, sepse nëse krahasojmë nivelin e industrializimit me ish-republikat jugosllave, Kosova kishte nivelin më të ulët të zhvillimit. Dhe një shtet apo rajon që nuk ka industri, e ka tepër të vështirë, nëse të pamundshme (kjo së paku në plan afatshkurtër dhe afatmesëm) ta ulë shkallën e papunësisë siç është sot në Kosovë e rajon.

Kosova dhe Evropa Juglindore në përgjithësi janë duke u përballur me shkallë të theksuar të de-popullimit si rezultat i

mungesës së perspektivës ekonomike, kryesisht si rezultat i deindustrializimit si motor i gjenerimit të punësisë. Ky trend do të vazhdojë edhe për një kohë të pacaktuar. Ndërsa, Zvicra, edhe pse është duke u përballur me plakje të popullsisë, ajo është duke e mbajtur gjallë produktivitetin ekonomik përmes migracionit, pra kryesisht me ardhës nga vendet jugore të BE-së, Evropës Juglindore dhe jo vetëm. Përderisa ekonomia e Zvicrës ecën me hapa të sigurt, ekonomia e Kosovës dhe rajonit ka trendë rritjeje, por të ngadalshëm. Pastaj, Zvicra është një lloj qendre financiare globale, ndërkohë që Kosova e rajoni as që pritet të bëhen të tillë.

Ka dhe një pjesë që thonë se Kosova është dashur të zhvillohet si Zvicra sepse ka shumë resurse nëntokësore. Po, vendet e rajonit a nuk paskan resurse?! Po Afrika apo rajonet e tjera të botës, a nuk paskan resurse?! Po të ishte për resurse, atëherë Arabia Saudite, Kuvajti, Iraku, Irani, Rusia do të duhej të ishin parajsë për kah niveli i zhvillimit ekonomik e që nuk janë, sepse kanë energjinë si resursi kryesor për zhvillim ekonomik pas ushqimit dhe ujit.

Në rrafshin tonë të brendshëm, luhatjet dhe polarizimet e ndryshme, shpesh me rend dite të ndryshme, kanë mbjellë një mendësi që flet për pengesat e politikës, apo të një pjesë të politikës, për zhvillimin e pakënaqshëm të Kosovës. Edhe pse nuk mund të themi që performanca politike ka qenë më e mira e mundshme. Pra, ka pasur defekte e çoroditje në segmente të caktuara ashtu siç ka pasur lëvizje pozitive në drejtime të caktuara. Shpesh harrohet, me apo pa qëllim, që buxheti vjetor i Kosovës sillet mes 1.5 deri në 2.5 miliardë euro. Prandaj, të drejtuarit e Kosovës, pa marrë parasysh ëndërrat, doemos që do të duhet të lëvizë nëpër premisat dhe kanalet e ndërtuara me shumë mund e sakrificë me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare. Çdo devijim nga ky kurs vetëm sa do të na dëmtojë në rrugëtimin tonë drejt BE-së dhe jo vetëm.

Ka një vrull cinik negativ, kryesisht për konsum të brendshëm, ku thuhet se po të mos ishin 'këta', 'ne' do ta bënë Kosovën Zvicër. Por, harrohet fakti se mundësitë e shteteve të vogla, e në këtë rast Kosovës, janë të kufizuara si rezultat i vështirësive të mëdha politike, ekonomike e sociale me të cilat jemi përballur dhe që na presin. Kemi për t'u anëtarësuar në mekanizma të ndryshëm rajonalë e ndërkombëtarë, ndërkohë që nuk njihemi si shtet nga OKB

# Ligjëratat e BIK-ut në burgje, nuk mjaftojnë për deradikalizim

dhe BE. Asnjë prej këtyre problemeve nuk i ka Zvicra. Pastaj, Kosova, edhe pse është e përkushtuar drejt integritet evropian, si rrugën e vetme për të ardhmen, nuk e ka mundësinë ta shfrytëzojë plotësisht tregun evropian sikurse Zvicra, e cila, edhe pse është kundër anëtarësimit në BE, është anëtare e tregut të përbashkët evropian, përfitimet e së cilës janë të jashtëzakonshme.

Edhe në aspektin e rezonimit shoqëror na duhet shumë kohë të bëhemi si Zvicra, kjo sepse, ne si shoqëri, e kemi shumë për qejf ta përmendim zbatimin e ligjit, pothuaj pa përjashtim, kurse në përballje me ligjin mundohemi të gjejmë rrugë se si të mos e zbatojmë atë. Ndërsa në Zvicër njerëzit nuk flasin më për zbatim të ligjit, sepse ata kanë arritur standard në këtë drejtim, pra ata vetëm e zbatojnë ligjin. Ose thënë më saktë, niveli i zbatimit të ligjit në Zvicër, krahasuar me atë në Kosovë, ka dallime të mëdha. Mjafton ta shohim degradimin mjedisor dhe ta shohim veten se ku jemi me zbatim të ligjit e shumë fusha të tjera.

Njerëzit tanë tërë kohën e shajnë dhe fyejnë shtetin për parregullsi e mosfunksionim, kurse vetë u ikin taksave, vjedhin, dëmtojnë mjedisin etj. Kurse njerëzit në Zvicër nuk kanë nevojë ta shajnë shtetin (edhe pse askush nuk i ndal nëse duan), as nuk ia vënë ndërkombëcën shtetit, por paguajnë kontributet. Ne kemi qejf të kemi qeveri me mentalitet skandinav, e vet jemi larg tij, sa shpesh nuk e dimë as kur zgjohemi nga gjumi e as kur shkojmë për të fjetur, pra 'si pula pa kokë'.

Nuk duhet të mendojmë asnjëherë se hyjnorja do të zbrësë nga qielli dhe do të na e rregullojë në mënyrë të përsosur funksionimin e shoqërisë dhe shtetit të Kosovës ashtu sikundër që nuk duhet asnjëherë të mendojmë se tokësorja, një krah politik, do të rregullojë çdo gjë në Kosovë në plan afatshkurtër. Sigurisht që përpjekjet për rritje të cilësisë në të gjitha drejtimet e mundshme duhet të jenë pjesë e vullnetit dhe projekioneve tona.

Shteti i Kosovës do të ecë me mundësitë e veta gjithnjë brenda kontekstit kohor dhe rrethanor. Çdo tentim për ndryshim të shpejtë dhe radikal të gjendjes pa një reformim të mirëfilltë të çdo gjëje do të shkaktojë përplasje jorezultative apo, siç thoshte filozofi gjerman Friedrich Hegel, "do të mund të ketë revolucion pa reformacion", e kur revolucioni bëhet pa reformacion, vendi shpërthen në dhunë të pashpresë. Kjo s'është duhet ta dëshpërojë askënd. E rëndësishme të rrojë Kosova!

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Deradikalizimi dhe risocializimi i personave nëpër qendrat e Shërbimit Korrektues në Kosovë, të cilët janë duke vuajtur dënime me burg për terrorizëm dhe ekstremizëm fetar, vazhdojnë të mbesin sfida, vlerësojnë përfaqësues të Bashkësisë Islame të Kosovës, të organizatave joqeveritare dhe njohës të sociologjisë së religjionit.

Një memorandum ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Qeverisë së Kosovës dhe Bashkësisë Islame të Kosovës, për ligjëratat e përfaqësuesve të kësaj të fundit në burgjet në Kosovë, kishte synuar që të ndikojë në deradikalizimin e personave që janë të dënuar për terrorizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm fetar.

Rexhep Lushta, imam në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili ka mbajtur ligjëratat në dy nga burgjet në Kosovë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se projekti i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Bashkësisë Islame të Kosovës nuk ka pasur për cak vetëm një grup të burgosurish, por në të kanë qenë të përfshirë të gjithë të burgosurit, pavarësisht nga veprat që ata i kanë kryer. Sipas tij, fatmirësisht në kohën kur është bërë marrëveshja nëpër burgjet e Kosovës kanë qenë edhe disa individë të cilët kanë qenë të akuzuar për terrorizëm, qoftë për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në vatrën e luftës në Siri apo qoftë edhe ata që e kanë përkrahur.

Lushta thotë se ka mbajtur ligjëratat në burgun e Dubravës dhe në Mitrovicën e Veriut. "Ligjëratat kanë qenë të natyrës vullnetare, nuk kanë qenë të obligueshme. Mirëpo, fatmirësisht ka qenë aty që të gjithë ata djem, të cilët kanë qenë në burgun e Dubravës, pa hezitim e kanë mirëpritur një veprim të tillë. Normalisht që asnjëri prej tyre nuk e ndien veten fajtor për veprat për të cilat ata janë ngarkuar. Mirëpo, sidoqoftë, mendoj se ata nuk e ndiejnë veten që janë njerëz të radikalizuar. Por, megjithatë, në ligjëratat tona, me këshillat tona, me bashkëpunimin që e kemi pasur me ta, mendoj se ka rezultuar me frytë dhe mendoj se ata djem, kur të dalin nga aty (burgu), vetëm sa do të jenë më të dobishëm për shoqërinë", ka thënë Lushta.

Shpat Balaj nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë thotë për "Radion Evropa e Lirë" se me gjithë efektet e dobishme që mund t'i prodhojnë ligjëratat e përfaqësuesve të BIK-ut nëpër burgje, ato janë të pamjaftueshme për rehabilitimin dhe risocializimin



e personave të radikalizuar. "Në parim, ky program është adekuat për rehabilitimin e këtyre personave. Por, sipas informatave që ne i kemi, disa prej tyre kanë refuzuar të jenë pjesë e këtij projekti. Andaj, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Bashkësinë Islame, duhet të gjejnë mekanizma të rinj, që të mund të t'i fusin këta persona në procesin e rehabilitimit, përmes atyre mekanizmave dhe jo të bëhen veprimet veç sa për t'u bërë, në aktivitetet e veta", ka thënë Balaj.

Ismajl Hasani, profesor i Sociologjisë së Religjionit, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se projekti i Ministrisë së Drejtësisë dhe BIK-ut është i mirë në parimin institucional. Por, sipas tij, në deradikalizimin dhe rehabilitimin e të dënuarve për terrorizëm dhe radikalizëm janë bërë gabime në hapa për shkak se, siç thotë ai, pjesë e korpusit të leksioneve, të këshillave, bisedave dhe kontakteve, është dashur të jenë edhe profilet e tjera të ekspertëve. "Para së gjithash, aty është dashur të përfshihen sociologët, punëtorët socialë, posaçërisht psikologët e profilit klinik, meqenëse do të shënoheshin krejtësisht efekte të tjera. Ata që vuajnë dënimin kanë shkuar (në luftëra të huaja) të motivuar, përveç të tjerash, edhe mbi bazën e një bindje të fortë fetare. Filozofia e qasjes së kësaj problematike duhet krejtësisht të ndërrojë nëse duam që brendapërbrenda qendrave korrektuese të shënojmë përparim", është shprehur Hasani. Megjithatë, Lushta thotë se në burgun ku ka ligjëruar nuk ka pasur raste që kanë refuzuar pjesëmarrjen në ligjëratat. Për më shumë, sipas tij, ligjëratat kanë pasur efekt. "Unë mendoj

se po mirëpo, ndoshta, do të ishte më mirë që Qeveria e Kosovës, në vend se t'i burgosë këta djem, të krijojë apo të hapë qendra rehabilituese të tipit të hapur, ku këta djem do të kenë mundësi t'i vijnë mësimet dhe edukimin. Por, në të njëjtën kohë, do të ishte mirë që përmes programeve psiko-sociale, edukative apo edhe përmes formave të ndryshme të angazhimit të tyre, të punësimit, të bëhet rehabilitimi i këtyre djemve. Nuk është e mjaftueshme që me këta djem të komunikohet vetëm në këtë mënyrë, prapa grilave. Ajo çfarë duhet bërë është që këtyre djemve t'u jepet mundësia e risocializimit në shoqëri", ka thënë Lushta.

Ndërkaq, Balaj thotë se mekanizmat që shfrytëzohen për rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar për terrorizëm, radikalizëm dhe ekstremizëm fetar nuk janë të veçantë, por të njëjtë që shfrytëzohen për të gjithë të burgosurit. "Këta persona që janë të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin, disa prej tyre e ndjekin edhe arsimin në shkollat që janë brenda institucioneve korrektuese. Gjithashtu, këshillohen edhe me psikologë që janë brenda institucioneve korrektuese. Por, nuk kam ndonjë informacion që është zhvilluar ndonjë program, përveç ligjëratave nga BIK-u vetëm për këta persona. Do të thotë, janë të njëjtët mekanizma që ekzistojnë edhe për të burgosurit e tjerë", ka deklaruar Balaj. Ai ka shtuar se nuk ka mjaft as informacione se kush janë ata psikologë dhe sociologë që janë duke punuar me të dënuarit për vepra që ndërlidhen me terrorizmin dhe nuk ka ndonjë studim se cilat janë rezultatet e atij angazhimi. Ndërkaq, profesor Ismajli thotë

se problemi vështirësohet për faktin se personat të cilët janë në vuajtje të dënimit me burg nuk mund të nxirren jashtë për të punuar me ta. Për këtë arsye, siç thotë ai, me ta duhet të punojnë profesionistët e profilizuar në mënyrë specifike. Por, megjithatë, sipas tij, institucionet e Kosovës, fillimisht duhet të punojnë me personat që janë nën mbikëqyrje, nën përkujdesje apo burg shtëpiak. "Mendoj se institucionet tona duhet të punojnë me këta njerëz që janë kategori tjetër. Ndërkaq, në qendrat korrektuese, e sidomos në Burgun e Sigurisë së Lartë, në mënyrë rigorozë duhet të dërgohen njerëzit profesionistë dhe njerëzit që e njohin teknikën e shkollës së terapisë integruese, të shkollës amerikane dhe të shkollës gjermane. Unë nuk e di që korpusi i këtyre profesionistëve, përfshirë sociologët dhe psikologët, të kenë pasur leksione të këtyre shkollave, aty ku kanë mbaruar studimet", ka thënë Ismajli.

Në anën tjetër, me gjithë insistimin e "Radios Evropa e Lirë" për të marrë përgjigje nga Ministria e Drejtësisë lidhur me këtë problematikë, zyrtarët e kësaj të fundit nuk janë përgjigjur.

Që nga viti 2012, kur në Siri kishte nisur konflikti, drejt Sirisë dhe Irakut kanë udhëtuar rreth 400 shtetas të Kosovës, burra, gra dhe fëmijë.

Duke luftuar krah organizatave terroriste, përkatësisht grupit militant Shteti Islamik (IS), janë vrarë më shumë se 70 shtetas të Kosovës. Personat që kanë arritur që të kthehen në Kosovë janë përballur me procese gjyqësore. Disa prej këtyre personave janë duke vuajtur dënime, ndërkohë që duke u hetuar janë edhe 32 gratë që u kthyen në muajin prill nga autoritetet kosovare.

## Michael Bloomberg zyrtarisht në garën presidenciale

UASHINGTON, 24 NËNTOR - Michael Bloomberg njoftoi të dielën se do të kandidojë për President të Shteteve të Bashkuara. Ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, një nga njerëzit më të pasur në botë, u bashkua zyrtarisht në fushatën presidenciale demokrate të dielën. Ish-republikani 77-vjeçar i njoftoi planet e tij në një faqe elektronike të fushatës.

Ai shkroi: "Po kandidoj për president për të mposhtur Donald Trumpin dhe për të rindërtuar Amerikën". Hyrja e Bloombergut në garë, vetëm 10 javë para fillimit të zgjedhjeve paraprake, reflekton shqetësimin e tij se lista aktuale e kandidatëve nuk është e pozicionuar mirë për të mposhtur presidentin Trump. Investimet masive të

Bloombergut në çështjet me përparësi për demokratët si ndryshimet klimatike dhe kontrolli i armëve të mbështetura nga pasuria e tij personale, mund ta bëjnë atë një kandidat të fuqishëm. Ai tashmë ka rezervuar më shumë se 30 milion dollarë në reklama televizive nëpër disa shtete, megjithëse nuk do të marrë pjesë në katër zgjedhjet e para paraprake.



# Kongresi dhe shanset për ngritjen e akuzave për shkarkimin e Trumpit deri në fund të vitit

Ndërsa ligjvënësit po përpiqen t'i përcaktojnë akuzat me qëllim ngritjen e tyre zyrtarisht falë një votimi përpara fundit të vitit në Dhomën e Përfaqësuesve, republikanët dhe demokratët mbeten thellësisht të ndarë në lidhje me këtë proces

UASHINGTON, 24 NËNTOR - Seancat dëgjimore në kuadër të hetimit për shkarkimin e presidentit Trump kanë ofruar detaje të reja rreth dyshimeve se Trumpi i bëri presion presidentit ukrainas Volodymyr Zelenskiy për ta hetuar kundërshtarin e tij demokrat Joe Biden dhe djalin e tij. Ndërsa ligjvënësit po përpiqen t'i përcaktojnë akuzat me qëllim ngritjen e tyre zyrtarisht falë një votimi përpara fundit të vitit në Dhomën e Përfaqësuesve, republikanët dhe demokratët mbeten thellësisht të ndarë në lidhje me këtë proces, ka njoftuar voa.

Dymbëdhjetë dëshmitarë brenda pesë ditësh sollën në seancat dëgjimore publike në kuadër të procesit për shkarkimin e presidentit dëshmitë e tyre rreth asaj që kishin dëgjuar ndërsa ishin të pranishëm gjatë bisedës telefonike së 25 korrikut mes presidentit Trump dhe homologut të tij ukrainas Zelenskiy. "Ishte e papërshtatshme që presidenti i ShBA-së i kërkoi një qeverie të huaj të hetojë një qytetar amerikan dhe një kundërshtar politik", tha kolonelejtënant Alexander Vindman, drejtor për Çështjet Evropiane në Këshillin e Sigurisë Kombëtare.

Dëshmitarët u thanë ligjvënësve se avokati personal i presidentit, Rudy Giuliani, u bëri presion zyrtarëve ukrainas që të shpallnin publikisht fillimin e hetimeve. "Të

gjithë e kuptuam që nëse nuk do të pranoni të punoni me Giuliani, do të humbim një mundësi të madhe për të forcuar marrëdhëniet mes ShBA-së dhe Ukrainës. Ndaj ndoqëm urdhrat e presidentit", tha Gordon Sondland, ambasadori amerikan në Bashkimin Evropian.

Por asnjë prej dëshmitarëve nuk i lidhi drejtpërdrejt kërkesat e Giuliani me Trumpin. Shqetësimet e Shtëpisë së Bardhë mbi korrupsionin vonuan lëvrimin e ndihmës, argumentuan republikanët. "Mendoj se presidenti dëshironte të sigurohej se do të kishte ndryshime në këtë drejtim në Ukrainë", tha Kevin McCarthy, udhëheqësi republikan i Dhomës së Përfaqësuesve. Për Nancy Pelosin dëshmitë provuan se presidenti Trump ka abuzuar me detyrën ç'ka përbën një veprim që duhet të çojë në ngritjen zyrtarisht të akuzave për shkarkimin e tij. "Kur shohim se është shkelur Kushtetuta, nuk kemi zgjidhje tjetër veçse të veprojmë. Provat janë të qarta se presidenti ka përdorur pushtetin e tij për përfitime personale. Duke ndaluar ndihmën ushtarake për Ukrainën ai minoi sigurinë kombëtare në dobi të rusëve. Ai ka minuar integritetin e zgjedhjeve tona me atë që ka bërë", tha Nancy Pelosi, kryetare e Dhomës së Përfaqësuesve.

Nuk është ende e qartë se kur



Dhoma e Përfaqësuesve do të votojë për të ngritur zyrtarisht akuzat për shkarkimin e presidentit. Pas përfundimit të hetimeve nga komisioni i Zbulimit që drejtohet nga Adam Schiff, procesi do të kalojë te Komisioni Juridik i Dhomës së Përfaqësuesve aty ku do të përcaktohet tërësia e akuzave ndaj presidentit me qëllim shkarkimin e tij. Por demokratët përballen ende me sfidën për të bindur publikun amerikan. "Ndoshta shumica e veprimeve janë të vështira për t'u kuptuar si një shkelje që mund të çojë në shkarkim. A është Trumpi pro apo kundër Ukrainës? Çfarë po ndodh saktësisht? Kjo është e vështirë për t'u kuptuar nga shumica e votuesve. Dhe pikërisht kjo është arsyeja se pse shumica e votuesve kërkojnë burime të besueshme për interpretimin e çështjes. Dhe sigurisht demokratët do të kërkojnë burime demokrate dhe republikanët, burime repub-

likane", thotë Hans Noel, i Universitetit Georgetown. Mbështetja publike për ngritjen e akuzave zyrtare për shkarkimin e Trumpit është rritur në muajt e fundit. Demokratët shpresojnë se

kjo tendencë do të vazhdojë ndërsa përgatiten për një votim të akuzave në Dhomën e Përfaqësuesve dhe një gjykim në Senat që me gjasë do nisë në fillim të vitit të ardhshëm.

## Presidenti aktual rumun, favorit për ta fituar edhe një mandat

BUKURESHT, 24 NËNTOR - Presidenti aktual i Rumanisë, Klaus Iohannis, duket se do të fitojë edhe një mandat presidencial, në raundin e balotazhit që u mbajt të dielën. Ai u sfidua nga ish-kryeministrja, Viorica Dancila, qeveria e së cilës u rrëzua muajin e kaluar, pas skandaleve korruptive.

Një mandat i dytë i Iohannis, do të rivendoste trajektoren evropiane të Rumanisë, pas disa vitesh qeverisjeje nga partitë e majta, që janë përshkruar me korrupsion dhe sulme ndaj sistemit gjyqësor.

Iohannis, 60 vjeç, ish-mësues i fizikës dhe kryetar i qytetit Sibiu, u ka bërë thirrje rumunëve që të dalin të votojnë. "Të dashur rumunë, është shansi juaj që ju të jeni kampion sot, përdorni votën tuaj për këtë, ju mund të gjithë mund të jeni kampion", tha ai pasi votoi në Bukuresht.

Dancila, që është lidere e Partisë Social-Demokrate, u tha gazetarëve se ka votuar "për një Rumani që ecën përpara dhe jo prapa".



## Papa Françesku në Hiroshima dhe Nagasaki

TOKIO, 24 NËNTOR - Papa Françesku u foli katolikëve në Hiroshima dhe Nagasaki të dielën, si pjesë e turneut të tij katërditor në Japoni duke predikuar një mesazh kundër armëve bërthamore.

82-vjeçi argjentinas mbërriti në Tokio të shtunën para se të shkonte në vendet ku u vranë më shumë se 100 mijë njerëz nga bombat atomike amerikane në

fund të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945.

Në Nagasaki të dielën, Papa Françesku u bëri thirrje udhëheqësve politikë të heqin dorë nga armët bërthamore dhe të braktisin garën e armëve. "U kërkoj udhëheqësve politikë të mos harrojnë se këto armë nuk mund na mbrojnë nga kërcënimet tanishme të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare", tha ai.

Papa ka thënë se ka qenë prej kohësh një ëndërr e tij të vizitonte Japoninë, dhe ka kërkuar të dërgohej atje si misionarë më shumë se 50 vjet më parë. Nga 126 milionë banorë të vendit, rreth 440 000 janë katolikë.

Para se të udhëtonte për në Japoni, Papa vizitoi Tajlandën për të predikuar një mesazh të tolerancës fetare dhe paqes.



## AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**

E rrallë

## Policët brazilianë patrullojnë me bufalo

Policët ushtarakë në ishullin brazilian të Marahos janë parë të patrullojnë me bufalë gjigantë. Fotografia e policëve ushtarakë u bë nga fotografi Fernando Kamara gjatë një vizite në ishull. Policia në këtë zonë e ka për traditë të dalë me këta thundrakë të mëdhenj, sipas fotografit. Maraho është një ishull sa Zvicra, që ndodhet pranë brigjeve veriore të Brazilit. Aty



rriten rreth 450 mijë bufalo të zbutur, gjë që bën që ishulli të ketë më shumë kafshë sesa njerëz.

FOTO E DITES



Një punëtore në Bangladesh shihet duke rregulluar qeset plastike të përdorura. /AFP/

E jashtëzakonshme

## Gruaja me 20 gishta këmbë dhe 12 gishta duarsh

Një grua 63-vjeçare, e lindur me 20 gishta këmbësh dhe 12 gishta duarsh, thotë se njerëzit e fshatit e quajnë shtrigë. Duke mos pasur para për një operim, ajo është e detyruar t'i durojë e të vazhdojë të jetojë me fqinjët përçmues në fshatin Ganxham të Indisë. Ndonjëherë mërztet aq shumë sa nuk del



fare nga shtëpia. Megjithatë, disa prej fqinjëve janë të mirë dhe vijnë ta vizitojnë duke i shprehur simpatinë.

### BARSOLETA E DITËS

**Toni: Po më shkruan baba në "Facebook". Goni: Edhe?**  
**Toni: Nuk po ia kthej. Goni: Pse?**  
**Toni: Se kur kam qenë i vogël baba më ka thënë mos me ia kthij fjalën!**

### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

## The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min  
**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.  
**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan

Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min  
**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.  
**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee

Çdo natë në ora 19:00

## FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min  
**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.  
**Regjia:** James Mangold

Çdo natë në ora 21:30

## TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min  
**Rolet:** Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.  
**Regjia:** Tim Miller

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: **Kino ABC**.

 <p><b>DASHI</b> Të lindurit e kësaj shenje do të shohin një mënyrë të re për t'u bërë të pasur. Megjithatë, mos nxitoni teksa merrni një vendim.</p>	 <p><b>DEMI</b> Ekziston mundësia të përfshihen nga pesimizmi. Do të ishte mirë nëse merrni pjesë në aktivitete të ndryshme, në mënyrë që të dilni nga kjo gjendje.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Mos u nxitoni në marrëdhënien tuaj romantike. Nuk përjashtohet një konflikt i mundshëm me partnerin/partneren, çfarë mund të çojë deri në ndarje.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot mund të vini re paqëndrueshmëri në marrëdhënien tuaj. Do ta keni të vështirë bashkëpunimin në punë. Ata që janë familjarë, ka gjasa të kenë probleme me fëmijët.</p>	 <p><b>LUANI</b> Ekziston mundësia që të përballemi me momente të pakëndshme gjatë ditës. Dikush do të përpiqet t'ju vërë në lojë qëllimisht. Sa i përket anës financiare, gjendja do të jetë e mirë.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Nuk këshillohet ta refuzoni këshillën e miqve. Ndoshta ky rekomandim do t'ju ndihmojë t'i shmangni problemet ose të tregoheni mjaft i kujdesshëm në çështjet personale.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Peshoret do të jenë të buzëqeshur dhe aktiv. Pozitiviteti do t'ju ndihmojë të pozicionoheni mjaft mirë në profesionin tuaj, ose për të gjetur një partner ideal për romancë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Do të befasoneni nga një surprizë mjaft e këndshme. Qetësohuni dhe mendoni se çfarë do të bëni në vijim.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Përpiquni të mendoni pozitivisht dhe të ecni përpara. Shfrytëzoni të gjitha shanset dhe mos hezitoni të merrni një vendim të rëndësishëm gjatë ditës së sotme.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Përpiquni maksimalisht t'i evitoni konfliktet me të tjerët. Vetëm në këtë mënyrë mund të shënoni sukses në aspektin profesional.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot mund të bëheni konfuz nga interesi i shtuar që po tregon dikush ndaj jush. Nëse nuk arrini ta kuptoni qëllimin e tij, bëni mirë të ftoni në një takim.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Bëni mirë t'i besoni intuitës nëse keni dyshime për vërtetësinë e fjalëve të dikujt. Çdo këshillë e marrë nga njëri të mençur do të jetë e vlefshme. Kontrolloni sjelljen dhe buxhetin tuaj.</p>


## Iggy Azalea dhe Playboi Carti thonë se iu vodhën bizhuteri në vlerë të 300 mijë dollarëve



**I**ggy Azaleas dhe të dashurit të saj Playboi Carti u janë vjedhur bizhuteritë me vlerë mbi 300 000 dollarë në rezidencën e tyre në Georgia. Ngjarja ndodhi më 14 nëntor në shtëpinë 6 500 metra katrorësh që çifti e ka me qira, por

nuk u raportua deri më 17 nëntor. Midis bizhuterive të vjedhura nga dhoma e ndenjës së rezidencës ishte një orë 57 mijë dollarëshe Audemars Piguet, një unazë diamanti 35 mijë dollarë dhe një zinxhir 39 mijë dollarësh.

## Justin Bieber i blen gruas orë mijëra dollarëshe për ditëlindje



**K**ëngëtari i njohur Justin Bieber dëshiron çdoherë që gruaja e tij Hailey Baldwin të jetë e lumtur. Ai për lumturinë e saj është i gatshëm ta paguajë mijëra dollarë. Bieber këtë herë

asaj për ditëlindje i dhuroi një orë të markës të "Audemars Piguet Royal Oak Offshore" e cila mban gurë të diamantit. Kjo orë kap vlerën e 150 mijë dollarëve amerikanë.



## Edhe Rita Ora preket nga gripi

**K**ëngëtarja e njohur kosovare Rita Ora është bërë pjesë e filmit "Twist" ku ka njërin nga rolet kryesore. Ora ka thënë se është e sëmurë dhe se ka marrë ndihmë mjekësore, për këtë ajo ka ndërprerë një pjesë xhirimeve të filmit. "Jo grip, nuk do të më mar-

rësh! Ndërprerjet e xhirimit të filmit në kohën e drekës/pushimi i katërt. Unë jam në rregull, vetëm dua që të siguroheni që unë do ta përfundoj këtë gjë para ditëlindjes time të martën! Dhe t'jua sjell këtë film të mahnitshëm! #Twist", ka shkruar Ora në "InstaStory".


## Jeff Bezos dhuron 98.5 milionë dollarë për familjet e pastreha



**D**rejtori i Përgjithshëm i "Amazon"-it, Jeff Bezos, ka njoftuar se ka dhuruar 98.5 milionë dollarë në vitin 2019 për 32 organizata që ndihmojnë në strehimin e familjeve të pastrehë.

Fondacioni i bamirësisë së miliardërit Bezos Day "1 Fund" ka bërë me dije lajmin për donacionet. Bezos hapi fondacionin në shtator të vitit 2018 dhe donacionet shkuan këtë vit për 32 organizata në 23 shtete.

# 'KOHA ËSHTË E MASKARENJVE, PO ATDHEU I SHQIPTARËVE!'



Agim VINCA

*I nderuar profesor Sokol Sadushi,  
Të dashur vëllezër dhe motra  
nga Vajza, Vlorë dhe gjithë  
Shqipëria,  
Zonja dhe zotërinj!*

Në pamundësi që të jem sot në mesin Tuaj, në ceremoninë e përirimit të bustit të poetit Ali Asllani, dëshiroj t'ju përhëndes me dy fjalë.

Bashkëfshatari Juaj, Ali Asllani, është një nga poetët më të shquar të letërsisë shqipe. Me vargjet e tij, që zunë fill këtu, në këtë fshat, Ai ngriti lart bukurinë e gjuhës shqipe dhe krenarinë e të qenit shqiptar.

Aliu këndoi për Vajzën, për Vlorën, për Labërinë dhe për gjithë Shqipërinë. Andaj, ashtu si pararendësit e tij të mëdhenj: Naimi me shokë, ai është poet që i takon mbarë kombit dhe jo vetëm krahinës nga vjen.

*Motra dhe vëllezër vajzotë,  
Mund të duket e pabesueshme,  
por është e vërtetë: në fshatin  
nga vij unë, në Veleshtën time  
rebele buzë Drinit të Zi (sot nën  
Maqedoni), fshatarët e njihnin  
Ali Asllanin dhe dinin për-  
mendsh vargje të tij. Më të  
zgjuarit i deklamonin ato në  
ndeja e kuvende.*

Dhe kur një poet e njohin jo vetëm shkollarët, por edhe fshatarët, kjo tregon sesa thellë

ka depërtuar ai në jetën e popullit që i përket; sesa është mishëruar me njerëzit e gjuhës dhe të gjakut të vet.

Sikurse të gjithë poetët shqiptarë, Ali Asllani shpreh dëshirën e bashkëkombësve të tij për të jetuar të lirë në tokën e tyre; në këtë vend që e cilëson me fjalët: "zot me pushkë e zot me pendë".

Në vitin 1920, kur filloi Lufta e Vlorës, poeti që i këndoi me aq delikatesë dashurisë, lëshoi kushtrimin për mbrojtjen e qytetit pararojë të Atdheut, Vlorës: "Vlorë, Vlorë, Vlorë, Vlorë, / rroki armët, bëja fora" dhe "Vlorë, Vlorë, Vlorë, Vlorë, / bjeri, moj, të lumtë dora!".

Dy herë në jetë do të jetë Kryetar i Bashkisë së qytetit të Pavarësisë, kurse në Qeverinë e Ismail Qemalit ushtroi detyrën e Kryesekretarit.

Ali Asllani ishte poet përgjithësisht i butë e lirik, por dinte edhe të hakërrehej kur e donte puna. Sot, kur shoqëria shqiptare përballat me probleme të shumta, ndër të cilat edhe pasurimi mar-ramendës i një kaste njerëzish në kurriz të popullit, tingëllojnë tejet aktuale vargjet e poezisë "Hakërrim", të shkruara në vitet '40, në kohën e okupimit fashist, ku thuhet: "Hani, pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepa, mbushni arka, / të pabrekë ju gjeti dreka / milionerë ju gjeti darka".

Sa herë që dëshpërohemi me atë që na shohin sytë dhe na dëgjojnë veshët, gjë që ndodh shpesh, ngushëllim gjejmë te vargu: "Koha është e maskarenjve, po atdheu i shqiptarëve!".

Në kujtesën e lexuesve shqiptarë, adhuruesve të poezisë së tij, Ali Asllani do të mbesë si lirik i dashurisë, i natyrës shqiptare, i

zakoneve arbërore dhe i një personazhi të paharruar, çfarë është protagonistja e poemës së famshme homonime, Hanka Halla.

Vepra e Ali Asllanit është botuar, lexuar dhe studiuar gjerësisht në Kosovë. Për të janë hartuar edhe tema të magistraturës dhe doktoratës, kurse emrin e tij e mbajnë edhe institucione kulturore e arsimore në Kosovë e Maqedoni. Kam kënaqësinë t'ju njoftoj se shkolla 9-vjeçare e fshatit Doganaj të qytetit që "vritet e pritet për Flamur", Kaçanikut, mban emrin e Ali Asllanit. Jam i lumtur që në rininë time kam punuar një vit mësues në këtë shkollë, atëherë me tjetër emër, duke ndikuar sadopak që ajo ta marrë emrin e poetit vlonjat.

*Të nderuar të pranishëm në ceremoninë e përirimit të bustit të Ali Asllanit,*

Njerëzit që nderojnë poetët, nderojnë veten!

Duke nderuar sot birin e fshatit tuaj dhe të Labërisë trime, poetin e shquar Ali Asllani, ju tregoni dashurinë për atdheun dhe vlerat e tij sipërore. Nga sot e tutje busti i poetit, vepër e artistit të merituar, skulptorit Muntaz Dhrami, do të stolisë sheshin e fshatit, duke e bërë kështu më të dashur për banorët dhe më tërheqës për vizitorët.

Urime për këtë gjest frymëzues e mbresëlënës në prag të festës së madhe të 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar dhe të Pavarësisë së Shqipërisë.

Gëzuar!

**Prishtinë, 22 nëntor 2019**

*(Fjalë e lexuar në ceremoninë e përirimit të bustit të poetit Ali Asllani në fshatin Vajzë të Vlorës më 23 nëntor 2019)*



## Ditët e kulturës shqiptare në Slloveni

**KOPËR, 24 NËNTOR (ER)** - Me një koncert për mërgimtarë nisën "Ditët e kulturës shqiptare" në Kopër të Sllovenisë, të cilat u organizuan nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe Shoqata "Iliria". Në simpoziumin e pestë, i cili u mbajt në Qendrën Historike të Koprit, u promovua numri i shtatë i revistës "Gjuha e vjetër shqipe në Istër".

Simpoziumin e hapi Hëset Ahmeti, kryetar i Shoqatës "Iliria", i cili foli për botimin e kësaj reviste. Panelistët, ambasadori i Shqipërisë, Pëllumb Qazimi, zëvendësam-basadori i Gjermanisë, dr. Bernhart Hauer, albanologu Paolo Muner, Ndue Lazri, shkrimtar, dhe Gëzim Muçolli dhe slloveni Peter Stoka referuan për gjuhën shqipe dhe toponimet shqiptare në Istër.



U vlerësua shumë i rëndësishëm botimi për herë të parë i dorëshkrimit të albanologut slloven Jernej Kopitar në vitin

1829. Vlen të theksohet se Shtoka ka dhënë kontribut të rëndësishëm për zbulimin e gjurmëve të hershme shqiptare

në Slloveni. Në këtë simpozium morën pjesë edhe ambasadori i Kosovës në Slloveni, Avni Katrati, përfaqësues të

shoqatave në Slloveni, të atyre në Itali etj.

Pas simpoziumit, në teatrin e qytetit, në prani të shumë personaliteteve të jetës politike dhe kulturore, si kryetari të komunës Koprit dhe shumë bashkatdhetarëve, u dha koncerti i tenorit të njohur shqiptar Kastriot Tusha. Tenori Tusha, i cili u përcoll nga pianistja Lule Elezi, interpretoi pjesë të zgjedhura të kompozimeve shqiptare. Në këtë mbrëmje kulturore, në emër të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, shoqata "Iliria" u nderua me mirënjohje për kontributin shumëvjeçar në promovimin dhe kultivimin e kulturës shqiptare. Po me këtë motivacion kjo shoqatë u dekorua edhe me titullin "Naim Frashëri", titull ky që jepet nga presidenti i Shqipërisë.



(Tregim)

# Gogoli

Dino BUXATI

Inxhinieri Roberto Paudi, asistent i drejtimit të Com-Prax dhe këshilltar i urbanistikës u inatos pa fund kur një mbrëmje dëgjoji dadon Ester e cila, për të zbutur një tekë të djalit të vogël, Frankos, i tha: "Shiko se po u solle keq, natën ka për të të ardhur Gogoli". Ishte e patolerueshme, sipas tij, që për të edukuar fëmijët të përdoshin ende këto besëtytni që mund të ngjallnin në psikikën e njomë, komplekse të përvuajtura. Kështu e qortoi vajzën e cila u largua e përplotur, e iu desh atij vetë të vinte në gumë të birin i cili shumë shpejt u qetësua. Të njëjtën mbrëmje, Gogoli, duke shkelur me majat e gishtave ajrin, siç e kishte zakon të lëvizte, u shfaq në dhomën ku inxhinier Paudi po flinte i vetëm, duke i ngjallur disa minuta drithërim.

Gogoli, siç dihet, merre në varësi të vendeve dhe të zakoneve lokale, forma të ndryshme. Në atë qytet, prej kohësh të hershme, mbante format e një kafshe gjigante me ngjyrë të errët, hija e të cilit luhatej midis hipopotamit dhe tapirit. I tmerrshëm në pamje të parë. Por nëse vëzhgohej me kujdes, vihej re, nga përthyerja e butë e gojës dhe nga shkëlqimi gati i dashur i vështrimit, një shprehje që mund të ishte gjithçka, përveçse e keqe.

Vetëkuptohet që në rrethana të një farë rëndësie, dinte të ngjallte të dridhura ose edhe frikë. Por zakonisht i çonte në fund ndërhyrjet e tij, me takt. Kur i avitej krevatit të fëmijës që do të ndëshkohej, as nuk e zgjonte fare, por depërtonte në ëndrrat e tij ku linte, kjo po, një gjurmë të përhershme. E dimë mirë, në fakt, që edhe ëndrrat e vogëlshëve të vegjël kanë një hapësirë të pakufizuar dhe pranojnë pa problem edhe krijesa vigane si Gogoli të cilët mund të kryejnë të gjitha veprimet e rastit në liri të plotë.

Natyrisht që kur iu shfaq inxhinier Paudit, krijesa antike nuk kishte një pamje shumë dashamirëse, por mbante fizionominë, kuptohet të stërmadhuar, të profesor Galurios, i emëruar prej dy muajsh si komisar i jashtëzakonshëm i COMPRAX-it, shoqëri që po notonte në ujëra të vështira. Dhe ky profesor Gallurio, njeri tejet i ashpër në mos po i pa komunikueshëm, qe pikërisht frika më e madhe e Paudit, pozita e të cilit në ndërmarrje, nën këtë situatë kontrolli, rrezikohej jashtëzakonisht.

Paudi, si u zgjua nën një petk djersësh të ftohta, arriti të shohë në kohë vizitorin që po ia mbathte përmes murit (dritarja nuk do të kishte qenë e mjaftueshme për ato përmasa të mëdha), duke i treguar kupolën monumentale të të pasmeve të tij.



Mëngjesin tjetër Paudi as mori mundimin t'i kërkonte ndjesë Esterit të giorë. Madje kur verifikoi personalisht që Gogoli ekzistonte vërtet, iu rrit, bashkë me përçmimin, vendosmëria e patundur për ta hequr me çdo kusht qafe këtë tipin.

Disa ditë më vonë, thujse me shaka, ai i kërkoi mendim graus, miqve, bashkëpunëtorëve. Dhe mbeti i habitur kur pa që ekzistenca e Gogolit përgjithësisht dihej nga të gjithë, si një ngjarje klasike e natyrës, sikundër shiu, tërmeti dhe ylberi. Vetëm doktor Xhemonio, i zyrës ligjore, mbeti pa mend kur e pyeti: po, i vogël pat dëgjuar të flitej nëpër mjegull për atë gjë, por pastaj ia mbushi mendjen vetës që ishte një përrallë kalamajsh pa thelb brenda.

Sikur ta dinte kundërshtinë e thekur të tij, Gogoli që nga ajo ditë filloi të frekuentojë me këmbëngulje të spikatur inxhinierin, gjithmonë nën maskën e pakëndshme të profesor Galurios, duke e përqeshur, i tërhiqte këmbët, e shkudte në shtrat, e një mbrëmje arriti aty sa iu kruspullua në gjoks, e për pak nuk i mori frymën. S'ka për t'u habitur atëherë nëse Paudi, në mbledhjen e radhës të Këshillit komunal e bisedoi me disa kolegë: a mund të lejohej në një metropol që mburrej të ishte në pararojë, përsëritja e një maskarallëku të tillë, i denjë për Mesjetën? A nuk ishte rasti që të zgjidhej përfundimisht kjo punë, me mjetet e përshtatshme?

Në fillim lindën pëshpërma korridore, shkëmbime jofor-male pikëpamjesh. Thënë shkurt, reputacioni që gëzonte inxhinier Paudi i hapi rrugën. Nuk kaluan as dy muaj kur problemi mbërriti në Këshillin komunal. Kuptohet vetiu, për të shmangur qesharaken, që rendi i ditës nuk e zinte goje Gogolin, por në nenin 5 përmendte vetëm një "fakt të

turpshëm shqetësimi për qetësinë mbrëmësore të qytetit".

Ndryshe nga ajo çka priste Paudi, jo vetëm që argumenti u prit seriozisht nga të gjithë, por teza e tij, që mund të tingëllonte së largu e qartë, ndeshi kundërshti të forta. U ngritën zërat në mbrojtje të kësaj tradite sa të padëmshme aq dhe piktoreske, që lindte në agun e kohërave, duke nënvizuar sa i padëmshëm ishte në tërësi përbindëshi i natës, veç të tjerash krejt i heshtur, si dhe duke zbuluar të mirat edukuese të pranisë së tij. Pati nga ata që folën deri edhe për një "atentat ndaj trashëgimisë kulturore të qytetit", nëse nuk do të ndërmerreshin masa represive; dhe oratori që e citoi u mbulua nga duartrokitjet.

Nga ana tjetër, në çështjen në fjalë, mbizotëruan në fund argumentet e parëzistueshme të të ashtuquajturit progres, që i përdor shumë shpesh për të shkatërruar fortesat e fundit të misterit. Gogoli u akuzua që linte një gjurmë të pashëndetshme në shpirtat fëmiorë, që ngjallte ndonjëherë makthe në kundërshtim me pedagogjinë zyrtare. Dolën në shesh edhe motivet e higjienës: po, është e vërtetë, përbindëshi i mbrëmjes nuk e bënte pis qytetin e as linte ndotje personale të asnjë lloji, por kush mund të garantonte që nuk ishte bartës i mikrobeve dhe i viruseve? Rreth tij, pastaj, nuk dihej asgjë konkrete mbi bindjet politike: si mund të përjashtohet që ndikimi i tij, në dukje aq i thjeshta, në mos i rëndomtë, tymos fshihte përbrenda kërcënime shkatërrimtare?

Debati në të cilin gazetarët nuk u lejuan, nisur nga delikatesa e temës, përfundoi në orën dy pas mesnate. Propozimi i Paudit u aprovua me një shumicë të ngushtë prej pesë votash. Për vënien praktike në jetë të tij u emërua një komision i posaçëm

ekspertësh, i udhëhequr nga vetë Paudi.

Në fakt, të deklaronte izolimin e Gogolit ishte një gjë, e tjetër gjë ishte eliminimi i tij. Pa dyshim që nuk mund të zihet besim në disiplinën qytetare të tij: aq më tepër që nuk dihej nëse ishte në gjendje të kuptonte gjuhën e folur. As nuk mund të mendohej dot që të kapej dhe t'i dorëzohej Kopshtit Zoologjik të qytetit: cili kafaz do të mund të mbante dot brenda një kafshë, nëse ishte kafshë, të aftë të kalonte mes për mes mureve? Edhe helmi duhej hequr nga lista: Gogolin nuk e kishin parë kurrë të hante apo të pinte. Flakëdhësi atëherë? Një bombë e vogël me napalm? Rreziku për banorët e qytetit ishte i tepërt në këto raste. Zgjidhja, pra, në mos e pamundur, paraqitej tejet problematike. Dhe ndërsa Paudi e ndjente t'i shpëtonte duarsh suksesi i dëshiruar, u shfaq një dyshim: po, përbërja kimike dhe struktura fizike e Gogolit ishin të panjohura, por, siç ndodh për shumë krijesa të regjistruara në gjendjen civile të legjendave, a s'mund të ishte shumë herë më i dobët dhe më i thyeshëm nga sa mendohej gjerësisht? Kush e di, ndoshta mjaftonte një plumb i thjeshtë, i gjuajtur në pikën e duhur dhe drejtësia do të vihej në vend.

Forcave të sigurisë publike, pas vendimit të Këshillit komunal të firmosur edhe nga kryetari i Bashkisë, s'iu mbetej veçse të bashkëpunonin. U krijua, në zemër të Skuadrës së policisë, një patrullë e veçantë, e pajisur me automjete të shpejta të ndërldhura me radio. Krejt kjo u realizua lehtësisht. Rrethana e vetme e çuditshme: një farë ngurrimi nga ana e nënoficerëve dhe policëve për të marrë pjesë në gjueti; ishte frikë? Ishte druajtja e errët e dhunimit të një porte të ndaluar? Apo thjesht një lidhje nostalgjike

me ndoca kujtime të furishme fëmijërie?

Takimi ndodhi në një natë të acartë hënëplotë. Patrulla e vendosur në një kënd të errët të sheshit Cinquecento e pikasi vagabondin tek çante ajrin, qetësisht, në 30 metra lartësi, i ngjashëm me një nëndetëse të vogël. Agjentët me armët në duar, bënë përpara. Përreth nuk ndihej asnjë frymë tjetër. Kërcitja e shkurtër e breshërive u dëgjua si jehonë shumë larg.

Skena ishte mjaft e pazakontë. Me ngadalë, Gogoli u vërtit rrotull vetes pa nxjerrë një pëshpërimë, e duke ngritur këmbët lart, u rrëzua ngadalë deri sa preku dëborën. Aty mbeti i shtrirë, i palëvizshëm, përgjithmonë. Drita e hënës reflektohej mbi barkun e stërmadh, të tendosur, që shkëlqente si llamarinë.

Diçka që do të preferoja mos e shihja për herë të dytë", rrëfeu më vonë tatar Cottafavi. Një pellg gjaku u zgjerua, në mënyrë të pabesueshme, poshtë viktimës, e zezë nën dritën e hënës.

U lajmëruan menjëherë me telefon ata të morgut për të hequr tutje kufomën. Nuk mbërritën dot në kohë. Në ato pak minuta gjëja gjigante, ashtu si ndodh me tullumbacet e shpuara, u shfry hap e mbyll sytë, u katandis në një larvë të giorë, u shndërrua në një krimbth të zi në të bardhën e borës, në fund edhe krimbthi u zhdruk, duke u tretur në hiç. Mbeti vetëm pellgu i turpshëm i gjakut të cilin e fshinë para mëngjesit hidrantët e pastruesve të rrugës.

U hapën fjalë se në qiell, ndërsa krijesa po jepte shpirt, shkëlqente jo një hënë, por dy. U fol që në gjithë qytetin, zogjtë e natës dhe qentë u ankuan përvajshëm shumë gjatë. U përsërit që shumë gra, të moshuara dhe fëmijë, të zgjuara nga një thirrje e errët, dilnin nga shtëpitë, të gjujzëzuara, duke u lutur për të gjorin. E gjithë kjo nuk është e provuar historikisht.

Në fakt, hëna e vazhdoi pa tronditje udhëtimin e paracakuar nga astronomia, orët kaluan rregullisht njëra pas tjetres dhe të gjithë fëmijët e botës vazhduan të flinin të qetë, pa e imagjinuar që miku-armik lozonjar kishte ikur njëherë e përgjithmonë. Pat qenë shumë tepër delikat dhe i ëmbël nga sa e besonin të tjerët.

Pat qenë i krijuar nga ajo substancë e pakapshme që vulgarisht quhet përrallë apo iluzion: megjithëse e vërtetë. Vrapo, arratisu, vrapo, fantazi e mbijetuar deri më sot. E etur për të të zhdrukur, bota civile të është qepur pas, nuk do të të japë më paqe.

\*Përktheu nga origjinali ERIS RUSI /Mapo.al/

Nga libri "NETËT E VËSHITIRA" Shtëpia e librit OMBRA GVG 1

# Oligarkët e sotëm nën dritën e Aristotelit



**Nga: Elife LUZHA**

Aristoteli, një nga mendimtarët më të mëdhenj të Greqisë së lashtë, në dy prej veprave të tij, mes atyre që kanë arritur t'u mbijetojnë shekujve, ka vënë jo vetëm bazat e disa fushave të dijes, por edhe themelet e progresit të mendjes njerëzore. Në veprën e njohur *Politika*, Aristoteli krijon shtyllat e mendimit politik mbi rregullimin shtetëror. Duke dhënë konceptet e tij mbi shtetin, pronën, pushtetin, ligjet, virtytin, qytetarët dhe raportet mes tyre, duke analizuar me detaje format e rregullimit shtetëror të poliseve (qytet-shteteve) greke, si dhe duke dialoguar me burrshtetasit dhe mendimtarët e kohës, ai arriti të sintetizojë mendime të dobishme dhe sjell përfundime të argumentuara, të cilat edhe sot vazhdojnë të jenë bazament i fuqishëm i kësaj fushe. Studiues të shumtë të veprës së Aristotelit e shohin *Politikën* si vazhdimësi të Etikës, vepër e cila përcakton etikën aristoteliane. Ndërsa *Etika* është vepër mbi individin, *Politika* paraqet një vepër mbi polisën (qytet-shtetin), dhe të dyja bashkë paraqesin leksionet e Aristotelit mbi "filozofinë e punëve njerëzore".

Si e tillë, *Politika* paraqet një sintezë idesh, tezash dhe konceptesh, që reflektojnë gamën e gjerë të dijes e përvojës së Aristotelit, si dhe thellësinë e mendimit analitik dhe kritik të tij. Nga këndvështrimi i strukturës, libri ndahet në tetë pjesë (libra), të cilat më tej ndahen në kapituj. Libri i parë përfshin diskutimet mbi qytetin, familjen, jetën shoqërore dhe pronën, për të vazhduar në librat e tjerë me trajtimin e çështjes së pushtetit më të mirë, llojet e monarkive, llojet e demokracive, llojet e oligarkive, qeverinë kushtetuese, krahasimin e kushtetutave, por edhe edukimin në shtetin ideal, që është objekti i librit të fundit. Nga problematikat që Aristoteli trajton brenda veprës *Politika*, do të ndalemi te pikëpamjet e tij rreth ligjit, të drejtës dhe moralit, si dhe ndikimin që kanë të tria këto në funksionimin e shtetit. Por, paraprakisht, do të prezantojmë disa nga konceptet themelore, që Aristoteli përdor në traktatet e tij mbi rregullimin e shtetit. Shteti, për Aristotelin, është "e mira më e lartë" që synon njeriu, si qenie e lindur për të jetuar në një bashkësi, sepse, sipas tij, njeriu për nga natyra është qenie shoqërore. "E ai që nuk mund të jetojë në bashkësi, sepse është i vetëmjaftueshëm

për veten ose është bishë, ose Perëndi", vazhdon më tej Aristoteli. Kjo është ideja bazë e Aristotelit për shtetin, ndërsa përkufizimin e plotë për rregullimin shtetëror e jep pas paraqitjes dhe analizës së formave të rregullimit shtetëror të poliseve greke, si Lakedaimoni, Sparta, Kreta, Karkedoni etj.: "Rregullimi shtetëror është njëfarë rendi midis njerëzve që jetojnë në një shtet. E gjithë veprimtaria e burrave shtetërorë dhe e ligdhënësve sillt rreth shtetit...". Meqë shteti si sistem kompleks përbëhet nga qytetarët, Aristoteli më tej i jep përgjigje pyetjes: *Kush është qytetar i shtetit?*, gjatë elaborimit të së cilës vërejmë se koncepti i tij për qytetarin ka të bëjë me të drejtat civile që i takojnë atij. Prandaj, sipas Aristotelit, "qytetar i një shteti është ai, i cili mund të marrë pjesë në pushtetin konsultativ dhe gjyqësor", pjesëmarrje kjo që e bën "shtetin një grumbull qytetarësh, të aftë për jetë ekonomike të pavarur". Nisur nga ideja se qytetarët janë themelet e një shteti, atëherë del se edhe funksionimi i suksesshëm i shtetit varet pikërisht nga qytetarët. Lidhur me këtë, Aristoteli thekson se "Virtyti i qytetarit është virtyti i shtetit. Ndërsa vesi i qytetarit është vesi

i shtetit". Në këtë pikë lind edhe dilema e mëtejme: *A mund të konsiderohen të njëjtë virtyti i njeriut të mirë dhe virtyti i qytetarit të mirë?*

Duke qenë se brenda shtetit qytetarët funksionojnë si një bashkësi, është e domosdoshme që çdo qytetar të kryejë si duhet funksionin që i është caktuar, në mënyrë që edhe shteti të funksionojë si duhet. Rrjedhimisht, virtyti i qytetarit të mirë apo të vyer është përgjegjësia e lartë ndaj detyrës që i është dhënë. Në këtë mënyrë, Aristoteli mendon se një qytetar mund të jetë i mirë dhe të ketë virtytet e qytetarit të vyer edhe nëse nuk është njeri i mirë, sepse, sipas tij, është e pamundur që të gjithë qytetarët e një shteti të jenë njerëz të mirë, por është e mundur që ata të jenë të vyer dhe të përmbushin detyrat e tyre. Qytetari i mirë duhet të zotërojë aftësinë e të sunduarit, por edhe aftësinë e të nënshtruarit, ndërsa virtyti karakteristik për drejtuesin, sipas Aristotelit, është urrejtja. Kur jemi te virtyti i qytetarit dhe virtyti i shtetit, duhet doemos të mbështetemi edhe tek *Etika* e Aristotelit, sepse *Etika* ka të bëjë kryesisht me veprimet e qenieve njerëzore si individë, ndërsa *Politika* ka të bëjë me veprimet e qenieve njerëzore në

bashkësi.

Tek *Etika*, Aristoteli të gjitha njohuritë i klasifikon në tri kategori: njohuritë teorike, njohuritë praktike dhe ato prodhuese. Të tria këto kategori dallojnë mes tyre për nga qëllimi. Kështu, njohuritë teorike synojnë soditjen; njohuritë prodhuese synojnë krijimin dhe njohuritë praktike synojnë veprimin. Fushat praktike të dijes adresojnë nevojat tona të përditshme si qenie njerëzore dhe kanë të bëjnë me gjëra që mund dhe duhet të ndryshojnë. Të tilla njohuri praktike janë edhe njohuritë mbi jetën apo, thënë ndryshe, njohuritë se si të jetohet dhe si të veprohet. Është pikërisht zotërimi dhe përdorimi i njohurive praktike, që, sipas Aristotelit, bën të mundur një jetesë të mirë. *Etika* dhe politika, gjithashtu, janë dy shkenca praktike, që merren me qeniet njerëzore dhe ndikojnë te to. Fakti që këto dy fusha Aristoteli i kategorizon te njohuritë praktike, tregon se dobinë e tyre ai e sheh jo në mësimin abstrakt apo teorik, por në zbatimin e etikës dhe politikës në jetë, sepse njohuria praktike është e dobishme kur veprimet në të.

Meqenëse të vepruarit në bazë të njohurive praktike kërkon përdorimin e arsyes, Aristoteli përjashton nga pjesëmarrja në

politikë gratë, të rinjtë dhe skllëvërit, ndërsa nga bashkësia e meshkujve të rritur zgjedh ata që kanë përvojë dhe disiplinë mendore. “Nëse në mesin e tyre dallohet ndonjë me virtyt dhe aftësi, duhet që të gjithë, me dëshirë e tyre, t’i nënshtrohen një njeriu të këtillë, kështu që njerëz të tillë mbesin deri në fund të jetës mbretër në shtete”. Mirëpo Aristoteli vë në dukje edhe rastet, kur në mesin e popullit shfaqen më shumë njerëz të mirë dhe me moral të lartë. Atëherë nuk udhëheq më vetëm njëri, por të gjithë marrin pjesë në pushtet dhe formojnë republikën. Ndërsa njeriut të virtytshëm, që është i vetmi që dallohet në mesin e të tjerëve e që Aristoteli i jep të drejtën e sundimit deri në fund të jetës, për grupin e të virtytshëmëve që formojnë republikën ai përmend mundësinë e çoroditjes dhe pasurimit nga bashkësia, që shpie në krijimin e oligarkisë, ashtu siç ndodhi në disa prej poliseve greke.

Pavarësisht nga forma e rregullimit shtetëror, si mbretëri apo republikë, për funksionimin e shtetit Aristoteli e sheh të domosdoshëm funksionimin e ligjeve, sepse “rregullimi më i mirë shtetëror është ai, në të cilin qeveriset vetëm në bazë të dispozitave dhe të ligjeve”. Në këtë përfundim Aristoteli vjen pasi shtron dilemën: “*Është më i dobishëm të nënshtrohet ndaj një njeriu më të mirë apo ndaj ligjeve më të mira?*”. Natyrisht që, në këtë çështje të shtruar, ai përkrah nënshttrimin ndaj ligjit, meqë ligjet janë pa pasione dhe, përmes tyre, arrihet gjykimi më i drejtë, ndërsa njeriu, sado i mirë që mund të jetë, është qenie me emocione dhe pasione, të cilat shpeshherë

mund t’ia turbullojnë aftësinë e të gjykuarit drejt. Nisur nga këto arsye, edhe në rastet kur ligjet nuk janë të mjaftueshme për ndonjë çështje, më mirë është të gjykojë masa sesa një njeri i vetëm, sepse “masa prishet më vështirë krahasuar me numrin e vogël të njerëzve”.

Nga sa u tha më lart, sipas Aristotelit, që shteti të ketë drejtësinë dhe rendin, duhet të ketë ligje, sepse ligji është e drejta që vlen njësoj për të gjithë qytetarët. Për më tepër, ai i konsideron ligjet si hyjnore, kur thotë: “Të kërkojë që të sundojë ligji, do të thotë të kërkojë të sundojë Perëndia, ndërsa të kërkojë të sundojë njeriu, do të thotë t’i lejosh edhe kafshës të sundojë, sepse epshi është diçka shtazarake, që i çorodit edhe njerëzit më të mirë kur janë në pushtet. Për këtë arsye ligji paraqet arsye pa dëshirë”. Këto gjykime të Aristotelit janë argumentuar në faza të ndryshme të historisë njerëzore dhe në shoqëri të ndryshme përgjatë shekujve. Nga sundimi i njerëzve që janë udhëhequr prej pasioneve të tyre, janë shkruar faqet më të errëta dhe më të përgjakshme të historisë. Edhe në kohën tonë, ngado gjenden shembuj të devijimeve të rregullimit shtetëror, që i aktualizojnë dhe i argumentojnë mendimet e Aristotelit.

Aristoteli konsideron se në shtetet ku udhëheqin njerëzit e pamoralshëm, nuk respektohen ligjet dhe, në këtë mënyrë, si rezultat, krijohen format e devijuara të rregullimit shtetëror. Prandaj, nga rregullimet më të drejta shtetërore, më të mira ai sheh ato ku qeverisin njerëzit e mirë. Prej këtu del edhe përparësia e demokracisë, ku

pushteti suprem është në duart e njerëzve të lirë, ndaj oligarkisë, ku pushtetin e kanë të pasurit. Më shumë njerëz të mirë e të virtytshëm ka mes njerëzve të lirë, pra shumicës, sesa në mesin e një grupi njerëzisht të pasur, të cilët këmbëngulin ta ruajnë pozitën e tyre dhe t’i keqinterpretojnë ligjet, apo të mos i përfillin ato. Gjithashtu, përmes demokracisë bëhet e mundur arritja e synimit kryesor të shtetit, që është arritja e së mirës së përgjithshme apo e plotësimi të nevojave të domosdoshme për të gjithë qytetarët, e jo vetëm të një pakice.

Gjithashtu, kur bëhet fjalë për njerëzit dhe ligjet, Aristoteli thekson përparësinë që ka shteti me qytetarë të moralshëm. Kjo, sepse vetëm ligjet, sado të mira qofshin ato, nuk mund të sigurojnë funksionimin normal të shtetit, nëse qytetarët nuk janë të virtytshëm dhe nuk i respektojnë ato. “Ligjet e mira sigurojnë rregullim të mirë shtetëror, vetëm kur njerëzit u nënshtrohen atyre.” Ky mendim na kthen te thënia e lartpërmendur e Aristotelit, se virtytet që e bëjnë njeriun të mirë, mund ta bëjnë edhe shtetin të mirë dhe funksional. Ndërsa për të qenë qytetarë të virtytshëm, është i domosdoshëm funksionimi i institucioneve demokratike, që do të siguronin edukimin e fëmijëve, pavarësisht nëse ata janë vijnë nga shtresa e pasur apo e varfër. Një kujdes i tillë në edukimin fëmijëve mundëson jo vetëm barazinë, por edhe krijimin e karakterit të qytetarët, që i bën ata të mirë dhe të disponueshëm për të kryer veprime fisnike.

Lidhjen mes qytetarit/njeriut


dhe rregullimit shtetëror Aristoteli e vazhdon edhe më tej, me diskutimin e mënyrës më të mirë të jetës, përcaktimin e së cilës e sheh si çelës për gjetjen dhe përkufizimin e rregullimit më të mirë shtetëror. Ai sugjeron tri lloje të së mirës: ajo që qëndron brenda nesh, e mira trupore dhe e mira shpirtërore, që kur janë të tria së bashku, e bëjnë njeriun të lumtur. Proporcioni i tri llojeve të së mirës brenda tërësisë duhet të jetë i caktuar, duke i dhënë përparësi gjithnjë të mirës shpirtërore, sepse njeriu është i lumtur, aq sa ka virtyt. Me njerëz të virtytshëm edhe shteti është i lumtur dhe në të punohet me nder. Aristoteli thekson se “guximi, drejtësia dhe urtësia e një shteti ka të njëjtën vlerë dhe shfaqen në të njëjtën formë, në të cilën shfaqen edhe tek individ, i cili vlerësohet si i drejtë, i matur dhe i mençur. “Meqë themelet e funksionimit të shtetit përbëhen nga ligjet, ligjvënësit kanë për detyrë të vendosin ligje, që u sigurojnë njerëzve brenda shtetit jetë të lumtur dhe jo të sigurohet një jetë e lumtur vetëm për njerëzit në pushtet.

Mendimi i Aristotelit, se “mënyra më e mirë e jetës për njeriun e lirë nuk është jeta e burrit të shtetit”, është një urtësi, të cilën duhet ta kenë si udhërrëfyes burrështetasit e sotëm shqiptarë, mënyra e qeverisjes e të cilëve tregon se postet udhëheqëse nuk i shohin si përgjegjësi, por si privilegje, duke i shfrytëzuar ekskluzivisht për të krijuar lumturinë vetjake, ndërkohë që populli nuk gëzon asnjë të mirë nën udhëheqjen e tyre. Kjo mënyrë e qeverisjes, që nuk ka të bëjë aspak me kon-

ceptin dhe qëllimin e shtetit si e mira më e lartë që synon njeriu, tregon se kemi të bëjmë me një formë të devijuar të rregullimit shtetëror, e cila sado që përpigjet të vishet me petkun e demokracisë, në fakt është oligarki.

Krijimi i së mirës vetëm për një grup të vogël njerëzish në pushtet bie ndesh me konceptin etik të Aristotelit për shtetin, që ai e përmbledh me pak fjalë: “Është e dëshirueshme dhe e kënaqshme që të përfitosh dhe të mbrosh *Të mirën e individit*, por është fisnike, hyjnore dhe sublime të përftosh dhe të mbrosh *Të mirën e komunitetit dhe të shtetit*”. Shteti që ndërtohet mbi bazën e koncepteve të Aristotelit dhe që udhëhiqet nga njerëz të virtytshëm, domosdoshmërisht është i suksesshëm dhe funksional. Nyja gordiane që shfaqet si pengesë në ndërtimin e shteteve, që do të siguronin mirëqenien e qytetarëve, në të shumtën e rasteve është marrja e pushtetit nga njerëzit e pamoralshëm dhe të papërgjegjshëm.

Si përfundim, është me rëndësi të theksojmë, se Aristoteli, së bashku me mësuesin e tij, Platonin, me shkrimet e tyre kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në vënie e themeleve të shumë shkencave. Aristoteli siguroi një sintezë të ndërlikuar të filozofive të ndryshme ekzistuese para tij dhe nga mësimet e tij qytetërimi perëndimor trashëgoi leksikon intelektual, si dhe problemet dhe metodat e hetimit. Si rezultat, filozofia e tij ka ushtruar një ndikim unik në pothuajse çdo formë të njohurive perëndimore dhe vazhdon të jetë temë e diskutimit filozofik bashkëkohor. /Telegrafi



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Ferizaj e fiton derbin e mbijetesës, Drita në vend të dytë



Klubi i Ferizajt mposhti të dielën Dukagjinin e Klinës dhe shtoi shpresat për të mbetur në garë për mbijetesë. Ndërsa të shtunën Drita e fitoi derbin kundër Llapit dhe në këtë mënyrë e ka rrëmbyer pozitën e dytë në IPKO Superligë. Fitore kanë shënuar edhe Prishtina dhe Drenica, kurse kampioni në fuq fuqi, Feronikeli, u ndal nga Flamurtari

faktin se diferenca në mes të dhjetë skuadrave të para është vetëm gjashtë pikë. Në fundjavë spikat fitorja e skuadrës së Malishevës në derbin ndaj Lirisë së Prizrenit me rezultat 1-0. Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Liman Gegaj" e shënoi Edonis Krasniqi. Ndërsa skuadra e Istogut ka arritur ta befasojë lideren e Ligës së Parë, Arbërinë (0-2), ndërsa Besa ndau pikët me KEK-un, duke luajtur në Obiliq me rezultat 1-1.

**IPKO SUPERLIGA - JAVA E 16**

Ferizaj - Dukagjini	2-0
Drita - Llapi	2-0
Flamurtari - Feronikeli	2-2
Drenica - Vushtrria	3-0
Prishtina - Trepça '89	1-0
Ballkani - Gjilani	2-1

**Tabela**

	PIKË
1. Ballkani	16
2. Drita	16
3. Gjilani	16
4. Prishtina	16
5. Feronikeli	16
6. Drenica	16
7. Llapi	16
8. Trepça '89	16
9. Flamurtari	16
10. Ferizaj	16
11. Vushtrria	16
12. Dukagjini	16

Në xhiron e radhës takohen: Llapi-Flamurtari, Vushtrria-Ballkani, Drenica-Ferizaj, Gjilani-Prishtina, Feronikeli-Dukagjini, Trepça '89-Drita.

**LIGA E PARË - JAVA E 15**

Vllaznia - 2 Korriku	0-3
Arbëria - Onix	0-2
KEK-u - Besa	1-1
Malisheva - Liria	1-0
Vëllaznimi - Ulpiana	2-1
Dardana - Drenasi	3-1
Vitia - Ramiz Sadiku	2-1
Istogu - Trepça	3-1

**TABELA**

	PIKË
1. Arbëria	15
2. Besa	15
3. Liria	15
4. Malisheva	15
5. Istogu	15
6. Onix	15
7. Drenias	15
8. 2 Korriku	15
9. Dardana	15
10. KEK-u	15
11. Trepça	15
12. Ulpiana	15
13. Vllaznia	15
14. Ramiz Sadiku	15
15. Vitia	15
16. Vëllaznimi	15

lanase i shënuar Betim Haxhimusa në minutën e 75-të, më pas Erjon Vucaj në minutat shtesë të ndeshjes. Flamurtari dhe Feronikeli ndanë pikët, pasi në kryeqytet luajtën 2-2. Fillimisht shënuar mysafirët nga penalltia pas pesë minutave lojë nëpërmjet Da Silvas, por vendësit u rikthyen fuqishëm në pjesën e dytë dhe e përmbysën rezultatit në 2-1, me dy golat e shënuara nga Shend Kelmendi. Kampionët në fuqi i shpëtoi nga humbja mesfushori Albert Dabiqaj që realizoi në kohën shtesë.

Fitore si vendëse arriti Drenica me rezultat bindës ndaj Vushtrrisë (3-0). Pjesa e parë e ndeshjes u mbyll 0-0, kurse në minutën e 73-të Përparim Osmani e hapi serinë e golave për kuqezinjët. Shtatë minuta më vonë realizoi Princ Balde, kurse rezultatit final e vulosi Arsen Sykaj që shënoi në minutën e 83-të. Prishtinës i mjaftoi goli i shënuar nga Ahmet Januzi për t'i marrë pikët e plota nga përballja me Trepçën '89 (1-0) e cila u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri".

## Liria bie në Malishevë, Onixi befason Arbërinë

Janë zhvilluar ndeshjet e javës së 15 në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Rivaliteti në këtë rang garash është shumë i madh për

**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 24 NËNTOR** - Skuadrat vendëse kanë fituar në pesë prej gjashtë ndeshjeve të xhiros së 16 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Vetëm përballja në mes të Flamurtarit dhe Feronikelit përfundoi baras (2-2), ani pse vendësit në këtë ndeshje ishin duke fituar deri në minutat shtesë. Të dielën derbin e skuadrave që po luftojnë për mbijetesë e fitoi Ferizaj në përballje me Dukagjinin e Klinës (2-0). Në minutën e 15-të Fatih Karahoda shënoi për 1-0, kurse golin e dytë e shënoi Taulant Dajaku (34) nga penalltia. Pas këtyre tri pikëve, Ferizaj është në vend të nëntë me 15 pikë, kurse Dukagjini mbetet në pozitën e fundit me vetëm tetë pikë. "Pas rezultatit 2-0 ekipi kundërshtar tentoi të rrezikojë, por ne ishim të kujdesshëm. Në pjesën e dytë Dukagjini na rrezikoi shumë, por jam i kënaqur me dy golat e pjesës së parë sepse nuk na ka ndodhur këtë edicion të shënojme dy të tillë për dyzet e pesë minuta. Kjo fitore erdhi me plot meritë dhe tashmë shohim kah ndeshjet e Kupës", ka thënë pas ndeshjes trajneri i Ferizajt, Bekim Isufi. Fitore në këtë xhiro shënoi Drita në derbin ndaj Llapit me rezultat 2-0 dhe në këtë mënyrë e ka rrëmbyer pozitën e dytë në tabelë. Golat për skuadrën gj-

**SHKURT**

## Xhemaili, shpëtimtar i Bolognas, Dërmaku titullar te Parma

Blerim Xhemaili ka shënuar gol në minutat shtesë për ta shpëtuar skuadrën e Bolognas nga humbja kundër Parmës (2-2). Për skuadrën e Parmës titullar ishte mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Kastriot Dërmaku, i cili ka filluar të bëhet lojtar shumë i rëndësishëm për klubin italian.

## UEFA sjell VAR-in në Maqedoni për ndeshjen ndaj Kosovës

Sipas "Sportmedia", VAR-i në Maqedoni do ta bëjë debutimin më 26 mars në duelin kualifikues të "Euro 2020" me Kosovën. Ky është një vendim i komisionit teknik të UEFA-s, që është një dëshmi tjetër që kjo ndeshje në mes të Maqedonisë dhe Kosovës mund të luhet vetëm në Arenën "Todor Proeski" në Shkup dhe askund tjetër në Maqedoni. Kështu që, më 26 mars për herë të parë në Maqedoni do të përdoret sistemi VAR. UEFA me siguri nuk dëshiron të rrezikojë asgjë në këto ndeshje finale të Ligës së Kombeve, të cilat do të vendosin se kush do të garojë në "Euro 2020".

## Shkëndija, tepër e fortë për Renovën

Shkëndija e Tetovës e fitoi me rezultatit të thellë 6-1 derbin ndaj skuadrës së Xhepçishtit, Renovës, duke vazhduar ngjytjen, teksa përfitoi edhe nga ndalesa që Shkupi i bëri Vardarit, për t'u afruar edhe më shumë me kreun. Omar Imeri, Alimi, Besar Ibrahim, Agim Ibrahim, Fazli dhe Totre shënuan për skuadrën e Ernest Gjokës, ndërsa golin e nderit për Renovën e shënoi Selmani.

## Rahoveci vazhdon me fitore, Trepça mposhtet nga Ylli

KB Rahoveci ka vazhduar me fitore, duke mundur Lipjanin në udhëtim me rezultat 79-116 (12-36, 19-30, 27-28, 21-24), në kuadër të xhiros së 12-të të Superligës së Kosovës në basketboll. "Vreshtarët" kanë qenë më të mirë nga fillimi deri në fund, duke shënuar fitore të merituar. Demarcus Stucky ishte më i miri te Lipjani me 40 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime, derisa te Rahoveci u dalluan Joshua McFolley me 20 pikë për 20 minuta dhe Javis Howard me 18 pikë e 12 kërcime. Ndërsa Trepça është mundur në shtëpi nga Golden Eagle Ylli me rezultat 77-88 (24-19, 16-25, 19-18, 18-26). Dj Hanes ishte më i miri te Trepça me 26 pikë, gjashtë kërcime dhe tetë asistime, kurse te skuadra mysafire u dalluan Alante Fenner me 21 pikë, gjashtë kërcime e pesë asistime, Samir Zekiqi me 20 pikë, dhjetë kërcime e katër asistime, si dhe Jameel McKay me 18 pikë e 15 kërcime.

## Prishtina e Vushtrria fitojnë me përmbysje

Ndonëse kanë humbur pjesët e para, Prishtina e Vushtrria i kanë fituar ndeshjet e javës së 11-të të Superligës së Kosovës në hendboll të luajtura të shtunën. Prishtina fitoi si mysafire ndaj Vëllaznimit në Gjakovë, ndërsa Vushtrria si mysafire ndaj Drenicës në Drenas. Në Gjakovë, Vëllaznimi kishte epërsi 18:16 pas pjesës së parë. Por Prishtina kishte fillim të furishëm të pjesës së dytë dhe krijoi epërsi që e mbajti deri në fund. Në fund rezultati ishte 39:31 në të mirë të Prishtinës. Prishtina është e dyta me 20 pikë, kurse Vëllaznimi mbetet në mesin e tabelës me 10 pikë. Në Drenas, Drenica e mbylli pjesën e parë me rezultat 15:12 në të mirë të saj. Vushtrriasit shpejt barazuan në pjesën e dytë, por lojë e barabartë u zhvillua deri në minutën e 50. Më pas Vushtrria u shkëput në tri gola (26:23). Drenica prapë u afrua në një gol në minutën e 58 (26:25), por vushtrriasit shënuan në minutën e fundit për rezultatit përfundimtar 27:25. Vushtrria renditet e gjashta me 10 pikë, sa i ka edhe Vëllaznimi në vend të pestë. Drenica është e shtata me 8 pikë.

## Donjeta Sadiku, përgatitje speciale në Zvicër

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Boksierja e mirënjohur dhe kandidatja për Lojërat Olimpikë "Tokio 2020", Donjeta Sadiku, së bashku me trajnerin Besim Brahimi janë në përgatitje spe-

ciale në Zvicër para Kampionatit Ballkanik që do të mbahet në Antalya (Turqi) më 10-15 dhjetor. "Këto përgatitje i ka mbështetur financiarisht Komiteti Olimpik i Kosovës ku

njëherësh Donjeta Sadiku është edhe bursiste. Këto përgatitje janë të mirëseardhura për Sadikun sepse në këto përgatitje marrin pjesë edhe boksieret nga Franca, Gjermania

dhe Zvicra. Me këtë rast Donjetës i mundësohet të ketë sparringje të cilat i mungojnë në Kosovë", thuhet në njoftimin e Federatës së Boksit të Kosovës.



## E ardhmja e Shaqirit, në Liverpool

LIVERPOOLI, 24 NËNTOR - Trajneri Jurgen Klopp ka zbuluar se e ardhmja e futbollistit shqiptar Xherdan Shaqiri është në Liverpool. Në këtë mënyrë trajneri gjerman ka shuar shpresat e Arsenalit që ta transferojë Shaqirin në afatin kalimtar të janarit. "Përse më duhet të flas për diçka që nuk është interesante për ne. Ai qëndroi pesë javë i lënduar dhe nuk ka mundur të luajë. Para lëndimit, po, mbase kemi folur se ai nuk po luante aq sa dëshironte. Kjo është e gjitha. Nuk kam çfarë të shtoj. Kur jam me të, ai është plotësisht i lumtur këtu", ka thënë Kloppi. "Natyrisht se Shaqiri e ka të ardhmen këtu. Ai është lojtar shumë i rëndësishëm për Liverpoolin", ka deklaruar Kloppi. Në anën tjetër edhe Xherdan Shaqiri vazhdon të insistojë për mos t'u larguar nga Liverpooli, edhe pse hapësirat e tij në këtë skuadër janë të pakta. Futbollisti me prejardhje nga Kosova sapo është rikthyer nga një lëndim që e mbajti rreth gjashtë javë jashtë fushave. Sikurse Kloppi, edhe Shaqiri ka mohuar zëra se do të largohet nga "Anfield"-i. 28-vjeçari ka



deklaruar se ka të ardhme te Liverpooli, pasi pret të marrë një rol kryesor në ekip. "Unë mendoj se kam të ardhme ende te Liverpooli. Dua ta pres rastin tim që të marr një rol kryesor në

skuadër në javët e ardhshme ashtu siç ka thënë Kloppi", ka deklaruar Shaqiri. Gjilanasi këtë edicion ka luajtur në vetëm katër takime për "The Reds" dhe në total ka 25 minuta.

## Lakersat dominojnë në Perëndim

MEMPHIS, 24 NËNTOR - Lakersat vijnë të dominojnë në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 109-108 ndaj Memphisit, jashtë fushës. Sukses i rëndësishëm i ekipit kalifornian, që doli fitues falë 30 pikëve të Jamesit dhe 22 të Davisit. Rikthehet te fitorja skuadra e San Antonios, që mundi 111-104 New Yorkun, sukses që i jep frymëmarrje Spursit. Më të mirët për San Antonio ishin Aldridge me 23 pikë e DeRozan me 21. Fiton edhe skuadra e Milwaukee, që



triumfoi 104-90 ndaj Detroitit, duke kryesuar renditjen në Konferencën e Lindjes. Vijnë të shkëlqejë greku Giannis Antetokounmpo, që realizoi 28 pikë e 10 rebounde për Bucksin.

Skuadra e Philadelphia, falë 32 pikëve të Richardsonit, mposhti 113-86 Miamin, ndërsa skuadra kampione e Torontos fitoi 119-116 në fushën e Atlantës, sfidë ku u dallua Siakami me 34 pikë.

### REZULTATET

Minnesota - Phoenix	98-100
Charlotte - Chicago	115-116
Indiana - Orlando	111-106
Atlanta - Toronto	116-119
New York - San Antonio	104-111
Philadelphia - Miami	113-86
Cleveland - Portland	110-104
Memphis - Lakers	108-109
Milwaukee - Detroit	104-90
Utah Jazz - New Orleans	128-120

### SHKURT

#### Arrestohet basketbollisti shqiptar që e grushtoi gjyqtarin

Një ngjarje e rëndë dhe mjaft e turpshme ka ndodhur të shtunën në mbrëmje në basketbollin shqiptar, në ndeshjen në mes të Teutës dhe Tiranës, në Pallatin e Sportit "Ramazan Njala", të qytetit të Durrësit. Basketbollisti i Tiranës, Bruno Daliu, në një çast pakënaqësie me gjyqtarin ka shkuar pranë njërit prej gjyqtarëve, Jurgen Muhos, dhe ka humbur toruan, duke e qëlluar disa herë me grushte dhe rrëzuar në tokë. Është dashur ndërhyrja e menjëhershme e shokëve të skuadrës së Daliut që të ndalej ky i fundit që, përveç gjyqtarit, goditi rëndë edhe imazhin e sportit të basketbollit në vendin tonë. Ndërkohë të dielën paradite, Policia e Shtetit njoftoi se ka arrestuar në flagrancë basketbollistin Bruno Daliu, me akuzën për goditje për shkak të detyrës, ndërsa materialet i janë referuar prokurorisë.

#### Wilderi shkatërron sërish Ortizin

Boksieri amerikan Deontay Wilder ka mbrojtur titullin kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC) pas fitores me "KO" në raundin e shtatë ndaj kubanezit Luis Ortiz. Kjo ishte sfida e dytë mes dy boksierëve, zhvilluar në Las Vegas, por ashtu si në duelin e parë rezultati nuk ndryshoi. Wilderi tregoi gjithë forcën e tij në ring, duke mposhtur rivalin 40-vjeçar, në humbjen e tij të dytë në karrierë, të dyja ndaj kampionit të botës. Një e djathtë e fuqishme e Wilderit në raundin e shtatë hodhi në tapet kubanezin, që ndryshe nga Fury, nuk u ngrit më. Sukses numër 42 në karrierë për amerikanin (ka edhe një barazim), që është ende i pamposhtur, ndërsa për Ortizin kjo është humbja e dytë, ndërkohë që numëron edhe 31 fitore. Një fitore që vjen 2 javë nga revanshi mes Joshuas dhe Ruizit, ndaj Wilderi lëshon një sinjal të fortë se është gati.

#### Mourinho kërkon Zaniolon

Trajneri Jose Mourinho po planifikon transferimin e yllit të Romës, Nicolo Zaniolo, në afatin kalimtar të janarit. Tottenhami për transferimin e këtij futbollisti ka përgatitur 50 milionë euro. Ndërsa në planet e trajnerit portugez janë edhe rinovimi i kontratave me Eriksenin, Alderwiereldin dhe Vertonghenin.

#### Conte lavdëron lojtarët e Interit

Trajneri i Interit, Antonio Conte, ka lavdëruar lojtarët e vet pas fitores ndaj Torinos. "Vërtet shpresoj që Barella mos të ketë dëmtim serioz. Barella është rritur gjatë këtyre katër muajve dhe është lojtar shumë i rëndësishëm për ne. Situata emergjente po vazhdon, por ne vetëm mund t'i falënderojmë lojtarët që po bëjnë punë të shkëlqyer. Këta lojtarë po sakrifikojnë vetën", ka thënë Conte. Interi është vetëm një pikë larg Juventusit, duke vazhduar kështu formën e shkëlqyer të këtij fillimsezonei.

#### Guardiola: Chelsea, klub i pabesueshëm

Manchester City e mposhti të shtunën skuadrën e Chelseat (2-1), por trajneri Pep Guardiola e ka lavdëruar skuadrën që drejtohet nga Frank Lampardi, duke e quajtur si klub të pabesueshëm. "Pasi pësua golin e parë, vuajtëm pak dhe rasti më i mirë ishte kur Kevini barazoi shifrat. Në pjesën e dytë e kontrolluam ndeshjen. Janë mjeshtër në pasime dhe klub i pabesueshëm. Në shtatë vjetet e fundit City fitoi më shumë trofe, por para kësaj Manchester Unitedi dhe Chelsea ishin më të mirët. Mund të shihni se klubet me të mira janë duke luajtur shumë mirë. Leicesteri, Liverpooli, Chelsea dhe skuadra jonë", ka thënë Guardiola.



<b>EPOKA E RE</b>		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	VËLLIMI, MASA	VËMENDJE E KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIÇKA (shq.)	AI QË DEHET ME ETER	SHKRIMTARJA KAMBERI	MIRË DE, NË RREGULL	SHTET NË AFRIKË	ZANORE	LLOJ PJEPI I VERDHË, I QULLËT E ME SHUMË LËNG, POR JO I SHIJSHËM	PËRHAPJA E VALËVE	BASHKËT.	<b>EPOKA E RE</b>
		AKTORJA ANGLEZE NË FOTO											JAM I DENJË TË NDEROHËM E VLEJ TË MË JEPET NJË ÇMIM
		MJET PËR PËRÇIMIN E VALËVE (shq.)							ALYSSA MILANO			BASHKËT. ORGANI I RIPRODHIMIT TË BIMEVE	
		SHTERPË QYTET NË SHQIPËRI							KAFSHË SHTËPIAKE PËRTYPËSE TENISTI SAFIN				
							AXHAMI, KALAMA AGIM TEJECI						
		ERA E KËNDSHME							KOMPOZITORI KOCI (shq.) PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE				
		LETRARI ..... ZYKO KAMBERI	QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; E KUJDESSHME DILETANTET							AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.) KËPUÇË PËR RRËSHQITJE MBI AKULL			
							DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS HISTORIANJA ..... KËÇMEZI BASHA					OHIO ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY	
<b>EPOKA E RE</b>	QË BËHET NDËRMJET TRI PALËVE	BARAZIM NË SHAH	PUNËTOR QË PASTRONTE E RREGULLONTE DHOMAT NË HANE (vjet.)	3.14 (mat.)	ZANORE	SHTET FEDERAL NË SHBA LETRARI XOXA						DY BASHKË-TINGËLLORE KAMPIONI	
	QYTET NË SHQIPËRI						ISLANDA KËNGËTARJA KANADEZE MORISSETTE		ANTON PASHKU KUNDREJT E VJETËR		RAST FILMI I PARË SHQIP		MUZIKOLOGU SHQIPTAR SOKOLI
	ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR .... JUPI					PËREMËR VETOR DY BASHKË-TINGËLLORE		E MBARUAR, E PËRFUNDUAR ZANORE					
	KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON		TRAJNERI BRAZILIAN LUIZ FELIPE SHKRITËTIRA MË E THATË NË BOTË							SHPIRTI (Lat.) SKUQJA E LËKURËS NGA ZGJERIMI I KAPILARËVE			
	FILOZOF NË GREQINË E LASHTË						PRINCESHA RUMUNE ..... GJIKA EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN					ARIAN MALIQI SHTET NË AZI	
	QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE					DAMARI I GJAKUT REKUZITË SPORTIVE (shq.)			FRYMA KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË			KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA DY BASHKË-TINGËLLORE	
	VEGËL MUZIKORE E PËRDORUR QË NË KOHË TË LASHTA (sh.shq.)					KËNGËTARJA ..... TARNER SHINË E TRENIT				ZANORE ERNEST KOLIQI	ROBERT REDFORD	BASHKËT. SHENJA MUZIKORE	
	SHKRONJA VIII & XVIII		HATA FARISHTË				DËSHMORI ..... PEÇI VIJË A RREMB UJI QË KALON NËN TOKË				SHTET NË AFRIKË TËPSI PREJ BALTE (sh.shq.)		
	BASHKËT.		I VRULLSHËM SHAPKA				MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI (pashq.)					TRUP GJEOMETRIK MJET SI KAMBANË FARE E VOGËL (sh.shq.)	
<b>EPOKA E RE</b>	FURRË KU PIQEN TULLA (sh.shq.) ATDHE							BASHKËT. KAJDE, OJNA (sh.shq.)		LËNG QË NXIRRET NGA KULLIMI I NAFTËS DHELPËRI (sh.shq.)			ISH FUTBOLLISTI YNË SHAQIRI
	PATRIOTI PASHKO					"ASHTU QOFTË" TOKË E BUKËS (sh.shq.)			FUTBOLLISTI SPANJOL MARTINEZ (shqip.)			SHKRONJA TË NJËJTA POETI .... RAÇI	
	VËLLAI I MADH					LLOJ KARROCE KUJAJSH NJËSI KOHE			ZANORE GAZETARJA SHIPTARE ... TIÇO		EMRI I PASHAIT TË JANINËS		SHKRONJA XXIV SHOUMENI KRASTA
	MUAJ I VITIT					NJERI I PACIPË E I PAFYTYRË, NJERI I POSHTËR MARK ANTONI					OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) NJË NGJYRË		
	ATALANTA, LIVORNO		KORNIZË BASHKËT.				FUTBOLLISTI ARGJENTINAS KARLOS ..... BASHKËT.				ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHERINGAM BASHKËT.		
	ANIJATË; PJESE E BRENDSHME E NJË KISHE (sh.shq.)						FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE					VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	

RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

